LIGJ
Nr.10 304, datë 15.7.2010

PËR SEKTORIN MINERAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË1

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi dhe objekti

Ky ligj përcakton rregullat për zhvillimin e veprimtarive minerare e postminerare në Republikën e Shqipërisë dhe ka për qëllim nxitjen e veprimtarisë minerare në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet sigurimit të transparencës dhe të konkurrencës së lirë në zhvillimin e kësaj veprimtarie, rritjen maksimale të përfitimit publik nga veprimtaria minerare dhe mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik nga rreziku minerar dhe ai i mbetjeve të industrisë minerare.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Shteti" është Republika e Shqipërisë.
2. "Ministria" është ministria që mbulon çështjet minerare.
3. "Ministri" është ministri që mbulon çështjet minerare.
4. "Mineral" është çdo substancë e dobishme, që ndodhet në trajtë natyrore, mbi ose nën sipërfaqen e tokës, në ujë ose nën ujë, e formuar prej proceseve gjeologjike, përjashtuar naftën, që është në gjendje të lëngët, gazin natyror që është në gjendje të gaztë dhe ujërat.
5. "Minierë" është çdo gërmim mbi ose nën tokë, përfshirë edhe pjesët nën ujë, dhe sterilet, çdo shpim ose pus kërkim-zbulimi, i cili është në punë ose jo, i bërë për qëllim kërkimi, zbulimi ose shfrytëzimi të mineralit, si dhe çdo vend tjetër, ku shfrytëzohet një pasuri minerare, përfshirë këtu zonën minerare dhe të gjitha ndërtesat, konstruksionet, strukturat, makineritë, pajisjet, dambat, rrugët ose objektet e tjera, të vendosura në një zonë të tillë, të cilat përdoren ose kanë si qëllim të përdoren për kërkimin, zbulimin, shfrytëzimin, përpunimin a përfitimin e një minerali, të nxjerrë në përputhje me dispozitat e këtij ligji.
6. "Veprimtari minerare" janë veprimtaritë e kërkimit, të zbulimit, të shfrytëzimit, të përpunimit, të mbylljes, të konservimit dhe të rehabilitimit të mjedisit minerar.
7. "Nëntokë" është çdo vend nën sipërfaqen natyrore të tokës, që lidhet me sipërfaqen e saj me anë të një pusi vertikal, traverbanku, tuneli, dishinteri, një kombinimi të tyre ose të çdo punimi tjetër minerar.
8. "Karrierë" është çdo vend ku nxirren minerale, drejtpërdrejt nga sipërfaqja, me anë të gërmimit ose të mënyrave të tjera, për të siguruar minerale për ndërtim, tregti e për qëllime industriale

1. Përafruar plotësisht me: 32006L0021, Direktiva e Parlamentit Europian dhe e Këshillit 2006/21/KE, datë 15 mars 2006 "Për menaxhimin e mbetjeve nga industritë nxjerrëse", Gazeta Zyrtare e Bashkimit Europian, L 102, datë 11.4.2006, fq. 15-34.

ose përpunuese.

9. "Kërkim minerar" është kryerja e operacioneve dhe e punimeve të nevojshme për kërkimin e mineraleve mbi sipërfaqen e tokës, për nxjerrjen dhe për lëvizjen e kampioneve minerare nga toka në sasi, për analiza, jo për tregti.

10. "Zbulim minerar" është kryerja e operacioneve të zbulimit, mbi ose nën sipërfaqen e tokës, si puse kërkimi, transhe, punime kërkimi dhe nxjerrja, lëvizja e provave minerare në sasi, për qëllime studimore, jo për tregti.

11. "Shfrytëzim minerar" është procesi teknologjik, që kryhet për nxjerrjen e një minerali/mineraleve, duke përfshirë kërkimin dhe zbulimin brenda zonës minerare të lejuar.

12. "Përpunim minerar" është trajtimi i mineralit/mineraleve, të nxjerra nga një minierë ose karrierë, nëpërmjet çdo procesi apo kombinimi procesesh, të cilave u nënshtrohen minerali/mineralet deri në formën e produktit të shitshëm.

13. "Rehabilitim i mjedisit minerar" është tërësia e veprimtarive që përfshijnë rehabilitimin progresiv e përfundimtar të mjedisit të zonës së lejuar minerare, rehabilitimin e sheshit të depozitimit të mbetjeve, si dhe të gjitha veprimtaritë e tjera, që realizon zotëruesi i lejes minerare, për parandalimin e dëmtimit të mjedisit e ndotjeve dhe për të garantuar një rehabilitim të plotë të ekosistemit në përgjithësi në zonën e lejuar minerare.

14. "Veprimtari studimore-projektuese" është veprimtaria që lidhet me studimin, projektimin, vlerësimin, konsulencën dhe drejtimin teknik të shoqërive.

15. "E drejtë minerare" është një leje minerare, koncesion, licencë për veprimtaritë studimore dhe projektuese ose autorizim për tregtimin e mineraleve të grupit të mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara, dhënë në përputhje me këtë ligj.

16. "Leje minerare" është akti administrativ, i dhënë në përputhje me këtë ligj, për të kryer veprimtari minerare në zonën e lejuar dhe për mineralet e përcaktuara në të.

17. "Zonë e lejuar" është zona e barabartë me projeksionin horizontal në sipërfaqen e tokës, për të cilën është dhënë një e drejtë minerare, për zhvillimin e veprimtarive minerare, e përcaktuar sipas koordinatave shtetërore të përcaktuara në plan horizontal.

18. "Zonë e rrezikshme e një të drejte minerare" është zona nën menaxhimin e zotëruesit të lejes minerare, e barabartë me projeksionin horizontal në sipërfaqen e tokës, për të cilën, sipas projektit të zhvillimit të minierës, quhet zonë me rrezik minerar dhe përcaktohet sipas koordinatave shtetërore të përcaktuara në plan horizontal.

19. "Zonë e rrezikshme" është zona e barabartë me projeksionin horizontal në sipërfaqen e tokës, për të cilën, sipas studimeve të strukturave përgjegjëse, ekziston rreziku minerar dhe nuk lejohet dhënia e të drejtave minerare dhe përcaktohet sipas koordinatave shtetërore të përcaktuara në plan horizontal.

20. "Zotërues i lejes minerare" është personi juridik, vendas ose i huaj, të cilit i është dhënë një leje minerare.

21."Kontratë me kushte lehtësuese" është një marrëveshje, me anë të së cilës zotëruesit të lejes minerare mund t'i krijohen disa lehtësi në ushtrimin e veprimtarisë minerare, në rastet kur kjo veprimtari minerare është me interes të veçantë publik.

22. "Interes publik" është një e mirë materiale ose jomateriale, në favor të publikut, që vjen si pasojë e ushtrimit të veprimtarisë minerare.

23. "Rentë minerare" është përqindja e vlerës së mineralit të shitur, që i paguhet shtetit nga zotëruesi i lejes minerare, si kompensim për zvogëlimin e burimeve minerare.

24."Monitorim minerar dhe postminerar" është vëzhgimi, regjistrimi, mbajtja nën kontroll i ndryshimeve fiziografike të tokës, ajrit, ujërave, sipërfaqësore apo nëntokësore, dhe ekosistemit në përgjithësi, në zonat ku ushtrohet apo është ushtruar veprimtari minerare, në zonat përreth tyre, si dhe marrja e masave parandaluese për fenomenet negative, që shfaqen gjatë apo pas veprimtarisë minerare.

25. "Plani i rehabilitimit të mjedisit" është projekti teknik, i realizuar në përputhje me kërkesat bazë të legjislacionit minerar dhe mjedisor në fuqi, në bazë të një pune studimore-projektuese, që përfshin të gjitha masat, që do të zbatohen për rehabilitimin progresiv e përfundimtar të mjedisit dhe kthimin e tij në gjendje të rehabilituar, rehabilitimin e sheshit të depozitimit të mbetjeve dhe mbylljen e veprimtarisë minerare, vlerën e përgjithshme të garancisë financiare për realizimin e këtij plani, para

zhvillimit të veprimtarive minerare, që paraqitet së bashku me dokumentacionin për marrjen e të drejtave minerare.

26. "Mbyllje e minierës" është tërësia e zbatimit të punimeve në terren, sipas një plani mbylljeje, të projektuar e të miratuar, për mbrojtjen dhe rehabilitimin e sipërfaqes së zonës minerare dhe trajtimin e ujërave e të gazrave, që dalin nga miniera, në përputhje me standarde të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, që përfshihen në planin e rehabilitimit të mjedisit.

27. "Plani për mbylljen e veprimtarisë minerare" është pjesë e planit të rehabilitimit të mjedisit dhe përfshin tërësinë e dokumentacionit teknik, ekonomik dhe të mjedisit, i realizuar në përputhje me kërkesat bazë të miratuara nga ministri, që justifikon mbylljen e veprimtarisë minerare dhe që përfshin veprimet e nevojshme, sipas afateve, duke garantuar financimin për marrjen e masave efektive për mbylljen e minierës, në bazë të kërkesave të legjislacionit minerar dhe mjedisor në fuqi, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare dhe paraqitet së bashku me dokumentacionin për marrjen e të drejtave minerare.

28. "Kolona mbrojtëse" janë pjesë të burimeve/rezervave minerare ose të shkëmbinjve rrethues, të cilat nuk shfrytëzohen dhe pranë të cilave nuk do të kryhen veprimtari minerare, për një periudhë të caktuar ose asnjëherë, për mbrojtjen e nëntokës e të sipërfaqes së zonës minerare, të argjinaturave të lumenjve ose sipërfaqeve të tjera dhe përfshihen në zonën e rrezikshme të një të drejte minerare.

29. "Servituti minerar" është servituti, sipas konceptit të Kodit Civil, por që lidhet vetëm me përdorimin e pronës, për efekt të realizimit të detyrimeve që rrjedhin nga lejet minerare.

30. "Projekt i zhvillimit të veprimtarisë minerare" është një plan i hollësishëm me afate për zhvillimin e veprimtarisë minerare, në bazë të kërkesave të legjislacionit minerar në fuqi dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare. Ky plan përfshin tërësinë e dokumentacionit teknik, ekonomik, financiar, social, si dhe vlerën e garancisë financiare për realizimin e programit minimal për lejet e kërkim-zbulimit dhe vlerën e investimit, me afatet për lejet e shfrytëzimit, duke garantuar financimin për realizimin e tij. Ky projekt paraqitet së bashku me dokumentacionin për marrjen e të drejtave minerare.

31. "Plan vjetor i veprimtarisë minerare" është plani i detajuar, që përfshin tërësinë e veprimtarive që do të realizojë zotëruesi i lejes minerare për zhvillimin e veprimtarisë së tij minerare gjatë vitit në vazhdim, veprimtaritë për rehabilitimin progresiv të mjedisit minerar dhe të sheshit të depozitimit të mbetjeve minerare, mbylljen progresive të veprimtarisë minerare, si dhe vlerën e investimit vjetor që do të realizohet gjatë atij viti, në përputhje me vlerën e investimit të miratuar, sipas projektit të zhvillimit të veprimtarive minerare dhe vlerën vjetore të garancisë financiare për rehabilitimin përfundimtar të mjedisit.

32. "Kadastra minerare" është një regjistër i veçantë inventarizimi sistematik i të dhënave për sendet e paluajtshme, mbështetëse të veprimtarisë minerare, tokë, ndërtesa dhe instalime të sipërfaqes apo nëntokës, në aspektin teknik, ekonomik, dhe të dhëna të tjera për zonat e lejuara minerare.

33. "Regjistri minerar" është regjistri që përfshin të gjitha të dhënat për regjimin juridik të sipërfaqeve të zonave minerare dhe të sipërfaqeve fqinje, pronësinë, situatën topografike të zonave minerare e të punimeve mbështetëse të veprimtarisë minerare, për rezervat dhe për prodhimin minerar, si dhe të dhënat për zotëruesin e lejeve minerare.

34. "Garanci financiare për rehabilitimin e mjedisit" është vlera monetare që depozitohet çdo vit, në formën e një garancie bankare në favor të shtetit, në një bankë të pranueshme për Ministrinë e Financave, që përdoret për realizimin e planit të rehabilitimit përfundimtar të mjedisit, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

35. "Strukturë përgjegjëse" është institucioni shtetëror, i përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, për të siguruar zbatimin e këtij ligji.

36. "Garanci financiare për realizimin e programit minimal të punës" është vlera monetare që depozitohet pas marrjes së lejes minerare të kërkim-zbulimit, sipas dispozitave të këtij ligji, në formën e një garancie bankare, në favor të shtetit, në një bankë të pranueshme për Ministrinë e Financave.

37. "Garanci financiare për realizimin e investimit" është vlera monetare që depozitohet pas marrjes së lejes minerare të shfrytëzimit, çdo vit, sipas përcaktimeve të këtij ligji, në formën e një garancie bankare, në favor të shtetit, në një bankë të pranueshme për Ministrinë e Financave.

38. "Mbetje të veprimtarisë minerare" janë të gjitha mbetjet solide, pulpat që rezultojnë nga procese të ndryshme, si pasurimi, lishivimi apo përpunimi i mëtejshëm metalurgjik, kimik, termik,

bakteriologjik e metoda të tjera apo kombinime të tyre, që mund të përdoren për prodhimin e produktit të gatshëm, mbetjet solide gjatë punimeve minerare, sipërfaqësore ose nëntokësore, përfshirë këtu të gjitha mbetjet që krijohen nga veprimtaria minerare e kërkim-zbulimit apo shfrytëzimit, si dhe dheu i sipërfaqes së zonës së lejuar minerare, që zhvendoset gjatë veprimtarisë minerare dhe depozitohet në stoqe, damba apo struktura të tjera depozitimi mbetjesh.

39. "Mbetje minerare të ish-ndërmarrjeve shtetërore minerare" është çdo substancë e dobishme, në gjendje të ngurtë ose të lëngët, e depozituar mbi sipërfaqen e tokës, e përftuar prej proceseve të shfrytëzimit të minierave apo nga proceset e përpunimit të mineraleve. Mbetjet minerare të përftuara nga aktiviteti i ish-ndërmarrjeve shtetërore minerare vlerësohen dhe shiten nëpërmjet procedurave të ankandit dhe shfrytëzohen me leje, sipas dispozitave të këtij ligji.

40. "Plan i menaxhimit të mbetjeve minerare" është tërësia e dokumentacionit teknik, ekonomik, social dhe mjedisor, i realizuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit minerar dhe mjedisor shqiptar në fuqi. Ai është pjesë e planit të rehabilitimit të mjedisit dhe përfshin projektin e depozitimit, mënyrat e trajtimit, të riciklimit dhe të menaxhimit të mbetjeve minerare, në bazë të karakteristikave të mbetjeve minerare të veprimtarisë minerare, si dhe ndikimin në mjedis, shëndetin e komunitetit, impaktin gjatë operimit, procedurat e kontrollit dhe të monitorimit, planin e mbylljes e të rehabilitimit të sheshit të depozitimit të mbetjeve, nivelin e shkarkimeve në mjedis, nivelin e koncentrimit të elementeve të rrezikshme në vendin e depozitimit. Ky projekt paraqitet së bashku me dokumentacionin për marrjen e të drejtave minerare.

Neni 3

Pronësia dhe përfaqësimi

Mineralet në trajtë natyrore, që gjenden në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në sipërfaqen nënujore, shtratit dhe nënshtratit të hapësirës detare shqiptare, përtej detit territorial, të përcaktuar sipas parimeve të së drejtës ndërkombëtare dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, i përkasin shtetit dhe janë prona publike.

Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, shteti, për efekt të zbatimit të këtij ligji, përfaqësohet nga ministri.

Neni 4

Parimet e veprimtarisë minerare

1. Veprimtaria minerare është veprimtari me interes publik.

2. Vendimmarrja në fushën e veprimtarisë minerare bëhet në kushtet e transparencës, paraprihet nga këshillimet me komunitetin e zonës dhe mendimin me shkrim të njësive përkatëse të qeverisjes vendore.

3. Veprimtaria në fushën minerare zhvillohet duke respektuar parimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të mbrojtjes së mjedisit.

4. E drejta minerare është një e drejtë e dallueshme dhe e pavarur nga e drejta e pronësisë mbi sipërfaqen e tokës, ku ato gjenden. Marrëdhëniet e subjektit përfitues të së drejtës minerare dhe titullarit të së drejtës së pronësisë mbi pronën, ku gjenden minerale, rregullohen me marrëveshje, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Strukturat shtetërore, që kanë në administrim/pronësi tokë, pronë publike, pjesë e zonës së lejuar të lejes minerare, kanë të drejtë të hyjnë në marrëveshje me subjektet që fitojnë një të drejtë minerare mbi këtë pronë publike, pa iu nënshtruar procedurave konkurruese për dhënie me qira ose emfiteozë, sipas çmimeve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

6. Për dëmtimet e shkaktuara ndaj të tretëve, nga zotëruesi i lejes minerare, përgjegjës është ky i fundit.

Neni 5

Dhënia e të drejtave minerare

1. Të drejtat minerare burojnë nga lejet minerare, të përcaktuara në këtë ligj.

2. Lejet minerare në zonat minerare, të përcaktuara në programin vjetor minerar si zona konkurruese, sipas nenit 8 të këtij ligji, u jepen subjekteve të interesuara, fituese të një konkurrimi

publik, ndërsa në zonat minerare të përcaktuara në programin vjetor minerar, si zona të hapura, sipas nenit 8 të këtij ligji, leja minerare i jepet subjektit të interesuar, që plotëson kushtet e lejimit, sipas parimit "I pari në kohë, i pari në të drejta".

3. Shteti mund t'u japë subjekteve juridike, vendase apo të huaja, të drejta minerare, për zonat konkurruese, sipas një procedure konkurrimi, në përputhje me kërkesat dhe afatet kohore të përcaktuara në dispozitat e legjislacionit në fuqi, për konkurrimin publik për dhënien e të mirave materiale. Procedura konkurruese duhet të përfshijë, gjithashtu kriteret teknike, financiare të investimit e rezultateve të tij dhe përvojën e konkurruesit në fushën e veprimtarive minerare. Procedura e konkurrimit dhe afatet përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Shteti mund t'u japë subjekteve juridike, vendase apo të huaja, të drejta minerare, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për koncesionet. Për ushtrimin e të drejtave minerare, marrëveshja koncesionare i nënshtrohet edhe përcaktimeve të këtij ligji.

KREU II
PLANIFIKIMI STRATEGJIK MINERAR

Neni 6
Instrumentet e vendimmarrjes strategjike

Vendimmarrja për zhvillimin e veprimtarive minerare në vend mbështetet në kuadrin strategjik të zhvillimit minerar që përbëhet nga:

a) strategjia minerare;

b) programi i veprimit për zbatimin e strategjisë minerare;

c) plani vjetor minerar.

Neni 7
Strategjia minerare

1. Strategjia minerare është dokumenti themelor, që përcakton politikat, përparësitë e zhvillimit, programet e veprimit dhe të administrimit të burimeve minerare për një periudhë 15-vjeçare, në përputhje me objektivat e strategjisë kombëtare të zhvillimit.

2. Strategjia minerare propozohet nga ministri, miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe publikohet në faqen e internetit të ministrisë e në Fletoren Zyrtare.

Neni 8
Programi i veprimit për zbatimin e strategjisë minerare dhe plani vjetor

1. Programi i veprimit për zbatimin e strategjisë minerare është dokumenti afatmesëm i planifikimit minerar, që hartohet në bazë të strategjisë minerare dhe është i vlefshëm për një periudhë 3-vjeçare.

2. Programi i veprimit për zbatimin e strategjisë minerare përmban:

a) drejtimet për zhvillimin e sektorit minerar;

b) promovimin e zonave minerare, për të cilat do të jepen lejet minerare, përmes procesit të konkurrimit apo procedurave të hapura;

c) promovimin e zonave minerare, mbështetur në hartën minerare dixhitale, e cila hartohet brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji dhe përditësohet vazhdimisht;

ç) programimin e veprimtarive të kërkimeve themelore gjeologjike;

d) parashikimin e përgjithshëm të produktit vjetor në sektorin minerar;

dh) nevojat për zhvillimin e burimeve njerëzore, profesionale në veprimtaritë minerare;

e) rregullat për zbatimin e masave për sigurinë në punë dhe sigurinë e punonjësve;

ë) rregullat për mbrojtjen e mjedisit, peizazhit dhe rehabilitimin e tij;

f) zonat e rrezikshme, ku veprimtaria minerare është e ndaluar dhe ku ndalohet dhënia e të drejtave minerare;

g) tabelën me vlerat minimale të sipërfaqes së zonës së lejuar të lejeve minerare, vlerën

minimale të investimit për lejet minerare të kërkim-zbulimit, si dhe vlerat minimale të prodhimit të mineralit për lejet e shfrytëzimit, për zonat konkurruese dhe zonat e hapura, sipas grupeve të mineraleve.

3. Përcaktimi i zonave, sipas shkronjave "b" dhe "c" të pikës 2 të këtij neni, dhe kriteret për përcaktimin e vlerës minimale të sipërfaqes, vlerës minimale të investimit dhe të vlerës minimale të prodhimit, sipas shkronjës "g" të pikës 2 të këtij neni, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Programi i veprimit për zbatimin e strategjisë minerare hartohet nga ministria dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit.

5. Në zbatim të programit të veprimit miratohet plani vjetor minerar, i cili përmban zonat minerare, për të cilat do të jepen të drejtat minerare, në vitin përkatës, zonat minerare, të drejtat minerare të të cilave përfitohen në bazë të një konkurrimi publik, në vijim zona konkurruese, dhe zonat e hapura, të drejtat minerare të të cilave përfitohen nga subjektet e interesuara, që plotësojnë kushtet e lejimit, në vijim zona të hapura.

6. Plani vjetor minerar hartohet nga struktura përgjegjëse dhe miratohet nga ministri, pas këshillimit me ministritë përgjegjëse për mjedisin, pyjet, tokën bujqësore, trashëgiminë kulturore, turizmin e mbrojtjen dhe njësitë e qeverisjes vendore përkatëse. Plani vjetor minerar është kalendarik dhe pas miratimit publikohet në faqen e internetit të ministrisë dhe në Fletoren Zyrtare dhe pasqyrohet në hartën minerare dixhitale.

7. Ministri miraton procedurat për përgatitjen e programit të veprimit për zbatimin e strategjisë minerare dhe të planit vjetor minerar, duke siguruar publikimin, transparencën dhe këshillimet me subjektet e interesuara gjatë këtij procesi.

8. Çdo ndryshim apo shtesë në planin vjetor miratohet dhe publikohet sipas së njëjtës procedurë.

Neni 9

Kriteret për përcaktimin e zonave minerare

1. Kriteret e përcaktimit të zonave minerare kanë karakter teknik, ekonomik e financiar dhe mbështeten:

a) për zonat konkurruese, në kapacitetin e njohur të rezervave minerare, interesin për llojin e mineralit, leverdinë ekonomike të prodhimit të produkteve të gatshme, vlerën e investimit të kërkuar, objektivat e zhvillimit ekonomik të vendit dhe planifikimin e territorit;

b) për zonat e hapura, në mundësinë e gjetjes së rezervave të reja minerare, interesin e veçantë të subjekteve, objektivat e zhvillimit ekonomik të vendit dhe planifikimin e territorit;

c) për zonat e koncesionit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Objekti i dhënies së lejes minerare të kërkim-zbulimit ose shfrytëzimit me proces konkurrimi, sipas kritereve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, janë të gjitha zonat:

a) e pambuluara me leje minerare, për të cilat disponohet informacioni i duhur gjeologjik, i konfirmuar nga struktura përgjegjëse, që procesi i kërkim-zbulimit është i panevojshëm për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, apo për grupin e mineraleve ndërtimore;

b) e lejeve të kërkim-zbulimit, nëse në përfundim të afatit të lejes subjekti minerar nuk i ka shndërruar në leje shfrytëzimi, edhe pse ka zbuluar rezerva minerare me interes publik;

c) e lejeve të shfrytëzimit të braktisura nga zotëruesit e lejeve;

ç) e minierave apo punimeve të vjetra minerare të braktisura, të cilat mund të rezultojnë me interes publik për shfrytëzim.

KREU III

KLASIFIKIMI I TË DREJTAVE MINERARE DHE TIPAT E LEJEVE MINERARE

SEKSIONI I PARË

KLASIFIKIMI

Neni 10

Klasifikimi

1. Veprimtaritë minerare klasifikohen, për efekt të këtij ligji, sipas tipit të veprimtarisë dhe llojit të mineralit.

2. Veprimtaritë minerare, sipas tipit, janë veprimtari:

a) kërkim-zbulimi;

b) shfrytëzimi;

c) kombinime të shkronjave a"e "b" të kësaj pike.

3. Mineralet, sipas llojit të tyre, klasifikohen në:

a) grupi i mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet;

b) grupi i mineraleve ndërtimore;

c) grupi i mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara;

ç) grupi i mineraleve radioaktive.

4. Mineralet, pjesë e çdo grupi, përcaktohen në aneksin, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Lejet minerare klasifikohen sipas tipit të veprimtarisë dhe grupit të mineraleve.

SEKSIONI I DYTË
LEJET PËR GRUPIN E MINERALEVE METALORE, JOMETALORE, QYMYRET DHE BITUMET

Neni 11
Leja e kërkim-zbulimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet

1. Leja e kërkim-zbulimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet i jep zotëruesit të saj të drejtën ekskluzive të kryejë punime për kërkim-zbulimin minerar brenda zonës së lejuar të përcaktuar në lejen minerare.

2. Leja e kërkim-zbulimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet jepet për një zonë të lejuar që është një e tërë, jo më e vogël se vlera e përcaktuar në tabelën e miratuar me vlerat minimale të sipërfaqeve të lejeve minerare sipas programit të veprimit, dhe jo më të madhe se 100 km^2.

3. Leja e kërkim-zbulimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet nuk mund të jepet për një zonë të lejuar, që është objekt i një lejeje tjetër kërkim-zbulimi apo shfrytëzimi, të vlefshme sipas këtij ligji, dhe që zotërohet nga një subjekt tjetër.

4. Subjekti mund të përfitojë njëkohësisht më shumë se një leje kërkim-zbulimi për zona të ndryshme të lejuara.

Neni 12
Të drejtat e zotëruesit të lejes së kërkim-zbulimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet

1. Zotëruesi i lejes së kërkim-zbulimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet ka të drejtë:

a) të hyjë në zonën e lejuar me punonjësit, mjetet, makineritë, pajisjet, që janë të nevojshme për kryerjen e punimeve të kërkim-zbulimit të mineraleve mbi ose nën sipërfaqen e tokës;

b) të kryejë veprimtari kërkim-zbulimi minerar dhe të kryejë punime të nevojshme për këtë qëllim, përfshirë puse kërkimi, transhe, si dhe punime të tjera kërkim-zbulimi të domosdoshme për kërkim-zbulimin minerar;

c) të nxjerrë, të lëvizë dhe të transportojë nga zona e lejuar provat e mineraleve në sasi për qëllime studimore e jo për tregti.

2. Zotëruesi i lejes së kërkim-zbulimit ka të drejtën e shndërrimit ndaj kërkuesve të tjerë për të përfituar një ose më shumë leje shfrytëzimi për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, për zona të lejuara shfrytëzimi brenda zonës së lejuar të kërkim-zbulimit.

3. E drejta e shndërrimit mund të ushtrohet gjatë gjithë afatit të vlefshmërisë së lejes së zbulimit dhe për një periudhë prej 60 ditësh kalendarike pas përfundimit të këtij afati dhe vetëm nëse

zotëruesi i lejes së kërkim-zbulimit ka plotësuar më parë detyrimet financiare për lejen e kërkim-zbulimit.

4. Nëse leja e kërkim-zbulimit shndërrohet në një ose disa leje shfrytëzimi përpara përfundimit të afatit të vlefshmërisë, detyrimet financiare për lejen e transformuar llogariten duke marrë parasysh edhe detyrimet e paguara.

Neni 13

Detyrimet e zotëruesit të lejes së kërkim-zbulimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet

Zotëruesi i lejes së kërkim-zbulimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet ka këto detyrime:

1. Të fillojë veprimtarinë e kërkim-zbulimit brenda 120 ditëve nga hyrja në fuqi e lejes.

2. Të realizojë programin minimal të punës, të përcaktuar në projektin e zhvillimit të veprimtarisë minerare.

3. T'i raportojë strukturës përgjegjëse gjetjen e çdo minerali me interes ekonomik në zonën e miratuar të kërkim-zbulimit brenda 10 ditëve kalendarike nga vlerësimi si i tillë.

4. Të heqë dorë, duke lënë pjesë të zonës së miratuar të kërkim-zbulimit, në mënyrë progresive, ose të realizojë pagesën vjetore për sipërfaqen e mbajtur për zhvillim veprimtarie kërkim-zbulimi, në përputhje me afatet e parashikuara në programin përkatës të punës, përkatësisht:

a) në fund të vitit të dytë zotëruesi i lejes së kërkim-zbulimit lë pjesë ose mban të gjithë sipërfaqen e zonës së tij të lejuar fillestare, me kushtin që për sipërfaqen e mbajtur, zotëruesi i lejes së kërkim-zbulimit duhet të paguajë një shumë që llogaritet për çdo kilometër katror të sipërfaqes së mbajtur për zhvillim veprimtarie minerare. Kjo shumë paguhet në datën efektive të fillimit të vitit të tretë të afatit të lejes së kërkim-zbulimit. Pagesa, sipas këtij neni, duhet specifikuar në lejen e kërkim-zbulimit dhe është 150 000 lekë për çdo kilometër katror;

b) deri në fund të përfundimit të afatit fillestar prej tre vjetësh, zotëruesi i lejes së kërkim-zbulimit lë, së paku, 90 për qind të zonës së lejuar fillestare, nëse kërkon zgjatje të afatit të lejes;

c) në rastin e kërkesës për shtyrje afati, zotëruesi i lejes së kërkim-zbulimit duhet të paguajë një shumë që llogaritet për çdo kilometër katror të zonës së mbajtur për zhvillim veprimtarie minerare në periudhën njëvjeçare të zgjatjes së lejes. Kjo shumë paguhet në datën efektive të fillimit të vitit të katërt të afatit të lejes së kërkim-zbulimit. Pagesa, sipas këtij neni, duhet specifikuar në dokumentin e shtyrjes së afatit të lejes së kërkim-zbulimit dhe është 150 000 lekë për çdo kilometër katror;

ç) deri në fund të shtesës prej një viti lë të gjitha pjesët e zonës së lejuar fillestare, që nuk shndërrohen në një leje shfrytëzimi minerar.

5. Të mbajë regjistrime të plota dhe të detajuara të punës së kryer për kërkim-zbulimin e mineraleve dhe operacioneve të tjera, në përputhje me lejen e kërkim-zbulimit. Këto regjistrime duhet të jenë në çdo moment të vlefshme në Shqipëri për inspektimin e veprimtarisë minerare të kërkim-zbulimit nga struktura përgjegjëse.

6. Të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dëmtimin e mjedisit, peizazhit ose pasurive të tjera.

7. Të rehabilitojë të gjitha dëmtimet e sipërfaqes së tokës, të cilat janë bërë gjatë kërkim-zbulimit.

8. Të respektojë kushtet dhe detyrimet e përcaktuara në lejen përkatëse.

9. Të realizojë programin e investimit, të parashikuar në planin vjetor të aktiviteteve minerare dhe projektin e zhvillimit të veprimtarive minerare.

10. Të paraqesë pranë strukturës përgjegjëse çdo 3 muaj, jo më vonë se data 15 e muajit që vijon pas tremujorit përkatës, një informacion mbi realizimin e investimeve, punimeve minerare të realizuara dhe gjithë operacioneve të kryera për rehabilitimin progresiv të mjedisit, në përputhje me detyrimet e tij të lejes minerare dhe planin vjetor. Forma e raportimit përshkruhet në aktet nënligjore që miratohen nga ministri.

11. Të paraqesë pranë strukturës përgjegjëse çdo vit, jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i vitit përkatës, raportin financiar dhe teknik të të gjitha operacioneve të kryera, në përputhje me detyrimet e përcaktuara në lejen e tij dhe planin vjetor të punës.

12. Të paraqesë për shqyrtim pranë strukturës përgjegjëse një plan pune vjetor, të hartuar në përputhje dhe të harmonizuar në kohë me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në lejen e tij minerare për çdo vit, jo më vonë se 30 ditë kalendarike përpara përfundimit të vitit, llogaritur nga data e hyrjes në fuqi të lejes. Ky plan duhet të përmbajë në mënyrë të specifikuar vlerën e investimeve, vlerat e garancive, të përcaktuara në nenin 31 të këtij ligji, në përputhje dhe të harmonizuar në kohë me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në lejen e tij minerare për çdo vit, të cilat miratohen nga strukturat përgjegjëse jo më vonë se 30 ditë nga data e paraqitjes së tyre. Në rast mosmiratimi, struktura përgjegjëse e njofton zotëruesin e lejes minerare për arsyet e këtij mosmiratimi. Nëse ajo nuk kthen përgjigje, pas tejkalimit të këtij afati, plani quhet i miratuar. Përmbajtja e planit të punës dhe dokumentet e tjera të nevojshme që e shoqërojnë duhet të jetë në përputhje me aktet nënligjore të miratuara nga ministri.

13. T'i raportojë strukturës përgjegjëse, në përfundim të afatit të vlefshmërisë së lejes, informacion të detajuar mbi investimet e realizuara gjatë kërkim-zbulimit, punimet e kryera në zonën e tij të lejuar, shoqëruar me vizatimet inxhinierike dhe rezultatet e të gjitha provave të marra. Forma e raportimit përshkruhet në aktet nënligjore që miratohen nga ministri.

Neni 14

Afati i lejes së kërkim-zbulimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet

1. Leja e kërkim-zbulimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet ka afat vlefshmërie 3-vjeçar. Afati i vlefshmërisë mund të zgjatet një herë, me kërkesë të zotëruesit të lejes. Zgjatja ka afat njëvjeçar.

2. Kërkesa për shtyrje afati duhet të paraqitet së paku 30 ditë kalendarike para mbarimit të afatit fillestar të vlefshmërisë.

3. Zgjatja e afatit miratohet vetëm nëse zotëruesi i lejes së kërkim-zbulimit paraqet të dhëna për mundësinë e zbulimit të një trupi minerar, ka plotësuar më parë detyrimet financiare, të parashikuara në programin minimal të punës, dhe investimet në afatet kohore, sipas programit të punës, në përputhje me lejen e dhënë, ka bërë pagesën për zonën që kërkon të mbajë për veprimtari kërkim-zbulimi, sipas përcaktimit të shkronjës "c" të pikës 4 të nenit 13 të këtij ligji.

4. Zotëruesi i lejes së kërkim-zbulimit është i detyruar të shpenzojë një vlerë të caktuar monetare për çdo kilometër katror të sipërfaqes së përcaktuar në lejen minerare, në mënyrë progresive për kryerjen e punimeve, sipas tabelës së përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Në rast se nuk shpenzohet vlera e përcaktuar, atëherë pjesa e mbetur i kalon Buxhetit të Shtetit.

Neni 15

Leja e shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet

1. Leja e shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet i jep zotëruesit të saj të drejtën ekskluzive të shfrytëzojë llojet e mineralit/mineraleve, të përcaktuara në leje, por brenda zonës së lejuar të shfrytëzimit, të përcaktuar në të.

2. Leja e shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet jepet për një zonë të lejuar, që është një e tërë, jo më e vogël se vlera e përcaktuar në tabelën e miratuar me vlerat minimale të sipërfaqeve të lejeve minerare, sipas programit të veprimit, dhe jo më e madhe se 10 km^2.

3. Leja e shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet jepet për një sasi prodhimi jo më të vogël se vlera e përcaktuar në tabelën e miratuar me vlerat minimale të prodhimit, sipas grupeve të mineraleve të lejeve minerare të shfrytëzimit, në përputhje me programin e veprimit.

4. Leja e shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet nuk mund të jepet për një zonë të lejuar, që është objekt i një lejeje kërkim-zbulimi apo shfrytëzimi, të vlefshme sipas këtij ligji, dhe që zotërohet nga një subjekt tjetër.

5. Me miratimin e lejes minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, zona e lejuar e shfrytëzimit hiqet nga fondi pyjor e kullosor, pronë shtetërore,

dhe kalon si pasuri minerare, në varësi të ministrisë së linjës, sipas legjislacionit në fuqi për ndryshimin e zërit kadastral të fondit pyjor e kullosor. Në këto raste, leja hyn në fuqi për zbatimin e detyrimeve të saj në datën e ndryshimit të zërit kadastral.

6. Subjekti mund të përfitojë më shumë se një leje shfrytëzimi për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, për zona të ndryshme, të lejuara njëkohësisht.

Neni 16

Afati i lejes së shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet

1. Leja e shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet ka afat vlefshmërie 25 vjet, nga hyrja në fuqi e saj. Afati i vlefshmërisë mund të zgjatet një herë për një periudhë 10-vjeçare, me kërkesë të zotëruesit të lejes. Kërkesa për shtyrje afati duhet të paraqitet, së paku, 1 vit para mbarimit të afatit të mëparshëm të vlefshmërisë.

2. Zgjatja e afatit miratohet, nëse zotëruesi i lejes së shfrytëzimit i ka plotësuar më parë detyrimet financiare dhe ka kryer investimet e parashikuara në programin e punës, në përputhje me lejen e dhënë, dhe paraqet një program pune shtesë, bindës për ministrin, për vazhdimin e mëtejshëm të veprimtarisë së shfrytëzimit.

3. Me kërkesë të subjektit kërkues apo të zotëruesit të lejes së shfrytëzimit, për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, dhe nëse paraqitet një plan investimesh, zbatimi i të cilit vlerësohet në interesin ekonomik apo shoqëror për komunitetin e zonës përkatëse, leja mund të jepet apo, përkatësisht, të zgjatet për një periudhë vlefshmërie deri në 99 vjet.

4. Në rastet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, ministri mund të negociojë një kontratë me kushte lehtësuese me kërkuesin apo zotëruesin e lejes minerare.

5. Në rastet e parashikuara në pikat 3 dhe 4 të këtij neni, kontrata dhe shtyrja e afatit paraqiten për miratim në Kuvend.

Neni 17

Të drejtat e zotëruesit të lejes së shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet

1. Zotëruesi i lejes së shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet ka këto të drejta:

a) të kryejë veprimet e nevojshme për të realizuar me efektivitet operacionet minerare në zonën e vet, të lejuar për shfrytëzim;

b) të nxjerrë dhe të lëvizë nga zona e vet e lejuar mineralin ose mineralet, për të cilat i është dhënë leja e shfrytëzimit;

c) të instalojë dhe të vërë në punë, brenda zonës së lejuar, objekte përpunimi, pasurimi, shkrirjeje, rafinimi, që rrisin vlerën e mineraleve të nxjerra në atë zonë, të lejuar për shfrytëzim, pasi të ketë marrë lejet përkatëse për veprimtari të tilla, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

ç) të ndërtojë, të instalojë dhe të vërë në punë, brenda zonës së lejuar, ndërtesa, kampe, mjedise depozituese, tubacione, gjeneratorë elektrikë, pajisje transmisioni, sisteme komunikimi, hekurudha, pajisje depozitimi të karburanteve dhe infrastruktura të tjera, të nevojshme për operacionet e punës, që lidhen me veprimtarinë minerare, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Shteti nuk ka detyrim të sigurojë ndonjë infrastrukturë brenda ose jashtë zonës së lejuar. Kur zotëruesi i lejes dëshiron të përdorë mjedise ose infrastrukturë shtetërore, të cilat përdoren për qëllime publike, ai fiton të drejtën ta përdorë këtë infrastrukturë veçmas lejes, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 18

Detyrimet e zotëruesit të lejes së shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet

1. Zotëruesi i lejes së shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe

bitumet ka këto detyrime:

a) të realizojë programin e investimit, të parashikuar në planin vjetor të veprimtarive minerare dhe projektin e zhvillimit të këtyre veprimtarive;

b) të paraqesë pranë strukturës përgjegjëse çdo 3 muaj, jo më vonë se data 15 e muajit që vijon pas tremujorit përkatës, një informacion mbi realizimin e prodhimit, investimeve, vlerën e produkteve të shitura, punimeve minerare të realizuara dhe gjithë operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve, në përputhje me detyrimet e lejes së tij minerare dhe planin vjetor;

c) të paraqesë pranë strukturës përgjegjëse çdo vit, jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i vitit përkatës, raportin financiar dhe teknik të të gjitha operacioneve të kryera, në përputhje me detyrimet e përcaktuara në lejen e tij dhe planin vjetor të punës. Forma e raportimit përshkruhet në aktet nënligjore që miratohen nga ministri;

ç) të paraqesë për shqyrtim pranë strukturës përgjegjëse një plan vjetor pune, të hartuar në përputhje dhe të harmonizuar në kohë me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në lejen e tij minerare, për çdo vit, jo më vonë se 30 ditë kalendarike përpara përfundimit të vitit, llogaritur nga data e hyrjes në fuqi të lejes. Ky plan duhet të përmbajë në mënyrë të specifikuar kapacitetet e prodhimit, vlerën e investimeve, vlerat e garancive të përcaktuara në nenin 31 të këtij ligji, në përputhje dhe të harmonizuar në kohë me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në lejen e tij minerare për çdo vit, të cilat miratohen nga strukturat përgjegjëse jo më vonë se 30 ditë nga data e paraqitjes së tyre. Në rast mosmiratimi, struktura përgjegjëse e njofton zotëruesin e lejes minerare për arsyet e këtij mosmiratimi. Nëse ajo nuk kthen përgjigje, pas tejkalimit të këtij afati, plani quhet i miratuar. Përmbajtja e planit të punës dhe dokumentet e tjera të nevojshme që e shoqërojnë duhet të jetë në përputhje me aktet nënligjore të miratuara nga ministri;

d) të japë informacione dhe shpjegime 1 vit më parë, nëse kërkon të ndërpresë veprimtarinë e prodhimit në zonën e lejuar;

dh) të njoftojë jo më pak se 90 ditë kalendarike më parë, nëse kërkon ta pezullojë përkohësisht veprimtarinë e shfrytëzimit në zonën e lejuar;

e) të njoftojë jo më pak se 30 ditë kalendarike më parë, nëse kërkon ta zvogëlojë më shumë se 20 për qind sasinë e prodhimit, të parashikuar në planin e miratuar të prodhimit, pjesë e lejes përkatëse;

ë) t'i raportojë strukturës përgjegjëse, në përfundim të afatit të së drejtës së shfrytëzimit, me një informacion të hollësishëm, siç përshkruhet në aktet nënligjore, të miratuara nga ministri, për investimet e realizuara gjatë shfrytëzimit, për punimet minerare të kryera në zonën e tij të lejuar, shoqëruar me vizatimet inxhinierike.

2. Njoftimi, sipas shkronjave “d”, “dh” dhe “e” të pikës 1 të këtij neni, duhet të përmbajë një informacion të hollësishëm për arsyet e pushimit, pezullimit apo uljes së prodhimit.

3. Pas miratimit nga ministri të ndalimit, pezullimit, uljes së prodhimit, sipas shkronjave “d”, “dh” dhe “e” të pikës 1 të këtij neni, zotëruesit i kthehet garancia vjetore për realizimin e investimit, sipas përcaktimeve të dhëna në njoftimin e tij.

SEKSIONI I TRETË
SHFRYTËZIMI I GRUPIT TË MINERALEVE NDËRTIMORE DHE LEJET

Neni 19
Leja e kërkim-zbulimit për grupin e mineraleve ndërtimore

1. Leja e kërkim-zbulimit për grupin e mineraleve ndërtimore i jep zotëruesit të saj të drejtën ekskluzive të kërkojë dhe/apo të zbulojë një ose më shumë nga mineralet e këtij grupi, të përcaktuara në leje, por brenda zonës së lejuar.

2. Leja e kërkim-zbulimit për grupin e mineraleve ndërtimore jepet për një zonë të lejuar, që është një e tërë, jo më e vogël se vlera e përcaktuar në tabelën e miratuar me vlerat minimale të sipërfaqeve të lejeve minerare, sipas programit të veprimit dhe jo më e madhe se 10 km^2.

3. Leja e kërkim-zbulimit për grupin e mineraleve ndërtimore nuk mund të jepet për një zonë

të lejuar, që është objekt i një lejeje kërkim-zbulimi apo shfrytëzimi, të vlefshme sipas këtij ligji, që zotërohet nga një subjekt tjetër.

4. Leja e kërkim-zbulimit ka afat vlefshmërie 1 vit nga hyrja në fuqi e saj.

5. Subjekti mund të përfitojë më shumë se një leje kërkim-zbulimi për zona të ndryshme, të lejuara njëkohësisht.

6. Të drejtat e kërkim-zbulimit brenda zonës së lejuar për grupin e mineraleve ndërtimore janë të njëjta me ato të përcaktuara në nenin 12 të këtij ligji.

Neni 20

Detyrimet e zotëruesit të lejes së kërkim-zbulimit për grupin e mineraleve ndërtimore

1. Zotëruesi i lejes së kërkimit-zbulimit për grupin e mineraleve ndërtimore ka këto detyrime:

a) të realizojë programin minimal të punës, të përcaktuar në projektin e zhvillimit të veprimtarisë minerare;

b) t'i raportojë strukturës përgjegjëse për punën e bërë në zonën e tij të kërkim-zbulimit, për shpenzimet dhe rezultatet e arritura, çdo 3 muaj, jo më vonë se data 15 e muajit që vijon pas tremujorit përkatës;

c) t'i raportojë strukturës përgjegjëse, në përfundim të afatit të së drejtës së kërkim-zbulimit, përmes një informacioni të hollësishëm, për investimet e realizuara gjatë kërkim-zbulimit, për punimet e kryera në zonën e tij të lejuar, shoqëruar me vizatimet inxhinierike dhe për rezultatet e të gjitha provave të marra;

ç) të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe për të zbutur ndikimet negative në mjedis, peizazh, dëmtimin e bimësisë ose pasurive të tjera;

d) të rehabilitojë të gjitha dëmtimet e sipërfaqes së tokës, të bëra gjatë zbulimit.

2. Mosparaqitja e raportit përfundimtar, sipas shkronjës "c" të pikës 1 të këtij neni, brenda 3 muajve nga përfundimi i afatit të së drejtës minerare, çon menjëherë (*ope legis*) në humbjen e së drejtës për t'u pajisur, në të ardhmen, me çfarëdolloj leje minerare, për zonën e tij të lejuar të kërkim-zbulimit.

3. Format e raportimit përshkruhen në aktet nënligjore që miratohen nga ministri.

Neni 21

Shfrytëzimi i grupit të mineraleve ndërtimore

1. Shfrytëzimi me karrierë i mineraleve ndërtimore kryhet në bazë të njërës prej lejeve të shfrytëzimit, të përcaktuara në nenet 23 e 24 të këtij ligji.

2. Përjashtimisht, shfrytëzimi i grupit të mineraleve ndërtimore është i lirë, në rastet kur:

a) autoritetet vendore dhe qendrore ose persona të tjerë të autorizuar prej tyre, të përfshira në ndërtimin e rrugëve publike ose në ndërtime të tjera publike, përdorin mbeturinat nga gërmimet e nevojshme;

b) zotëruesi i lejes së shfrytëzimit minerar merr minerale ndërtimore prej zonës së lejuar dhe i përdor në operacionet e veta minerare;

c) subjekte të tjera, të përfshira në ndërtimin e veprave, të shpallura me interes publik, përdorin minerale ndërtimore të nxjerra nga gërmimet apo punimet e nevojshme për realizimin e këtyre veprave, sipas projekteve të miratuara të ndërtimit.

3. Çdo mosmarrëveshje, që lidhet me shkronjat "a", "b" e "c" të pikës 2 të këtij neni, zgjidhet me vendim të ministrit, vendimi i të cilit është përfundimtar.

4. Leja e shfrytëzimit të karrierave, në asnjë rast nuk jepet për sipërfaqe toke bujqësore të kategorisë I deri në IV të bonitetit.

Neni 22

Karrierat për qëllime publike vendore

1. Njësitë e qeverisjes vendore mund t'i propozojnë ministrit miratimin e zonave minerare-

karriera, për t'u shfrytëzuar për qëllime publike vendore, në sipërfaqet në pronësi të njësisë përkatëse.

2. Ministri shqyrton propozimin dhe vendos, në bazë të programit vjetor të zbatimit të strategjisë, brenda 60 ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës.

3. Shfrytëzimi i karrierave për qëllime publike vendore, sipas përcaktimeve të nenit 23 të këtij ligji, mund të bëhet vetëm nga subjekti i krijuar nga njësia e qeverisjes vendore, në pronësi dhe në juridiksionin e së cilës ndodhet karriera, por vetëm pas pajisjes së saj me leje shfrytëzimi, sipas procedurave të këtij ligji.

Neni 23

Leja e shfrytëzimit të karrierave për qëllime publike vendore

1. Leja e shfrytëzimit të karrierave për qëllime publike vendore i jep subjektit të krijuar nga njësia përkatëse e qeverisjes vendore të drejtën t'i shfrytëzojë mineralet ndërtimore nga karriera publike për qëllime vendore.

2. Leja e shfrytëzimit të karrierave për qëllime publike vendore jepet për një zonë të lejuar, që është një e tërë e jo më e madhe se 1 km^2, e përcaktuar në hapësirë, sipas koordinatave shtetërore të përcaktuara në planin horizontal.

3. Subjekti i njësisë së qeverisjes vendore mund të përfitojë më shumë se një leje shfrytëzimi për zona të ndryshme të lejuara, por nuk mund të zotërojë më shumë se 2 leje shfrytëzimi njëkohësisht.

4. Leja e shfrytëzimit të karrierave për qëllime publike vendore ka afat vlefshmërie jo më shumë se 3 vjet, me të drejtë rinovimi për një vit, sipas kërkesës së zotëruesit, e cila duhet të paraqitet, së paku, 30 ditë kalendarike përpara datës së mbarimit të lejes së mëparshme.

5. Shfrytëzimi i karrierave për qëllime publike vendore mund të bëhet nga subjekti i njësisë së qeverisjes vendore, i krijuar sipas legjislacionit në fuqi.

6. Subjekti i sipërpërmendur respekton të gjitha rregullat dhe dispozitat e këtij ligji për ushtrimin e të drejtave minerare për lejet e shfrytëzimit të grupit të mineraleve ndërtimore.

Neni 24

Leja e shfrytëzimit me karrierë të grupit të mineraleve ndërtimore

1. Leja e shfrytëzimit me karrierë të mineraleve ndërtimore i jep zotëruesit të saj të drejtën ekskluzive për të hapur dhe për të shfrytëzuar një karrierë të tillë, të përcaktuar, dhe brenda zonës së lejuar për të.

2. Leja e shfrytëzimit jepet për një zonë të lejuar, që është një e tërë, jo më e vogël se vlera e përcaktuar në tabelën e miratuar me vlerat minimale të sipërfaqeve të lejeve minerare, sipas programit të veprimit dhe jo më e madhe se 5 km^2.

3. Leja e shfrytëzimit jepet për një sasi prodhimi jo më të vogël se vlera e përcaktuar në tabelën e miratuar me vlerat minimale të prodhimit, sipas grupeve të mineraleve të lejeve minerare të shfrytëzimit, sipas programit të veprimit.

4. Një zotërues i lejes së shfrytëzimit me karrierë të mineraleve ndërtimore mund të ketë, njëkohësisht, më shumë se një të tillë.

5. Leja nuk mund të jepet për një zonë të lejuar, që është objekt i një lejeje tjetër kërkim-zbulimi apo shfrytëzimi, të vlefshme sipas këtij ligji, që zotërohet nga një subjekt tjetër.

6. Leja e shfrytëzimit e grupit të mineraleve ndërtimore ka afat vlefshmërie jo më të gjatë se 25 vjet nga data e hyrjes së saj në fuqi dhe është subjekt i një shtese, deri në 10 vjet, me kusht që kjo shtyrje afati të kërkohet nga zotëruesi i lejes, të paktën, 180 ditë kalendarike para përfundimit të afatit të vlefshmërisë.

7. Me kërkesë të subjektit kërkues apo të zotëruesit të lejes së shfrytëzimit të grupit të mineraleve ndërtimore dhe nëse paraqitet një plan investimesh, zbatimi i të cilit vlerësohet me interes ekonomik apo shoqëror, për komunitetin e zonës përkatëse, leja mund të jepet apo, përkatësisht, të zgjatet për një periudhë vlefshmërie deri në 99 vjet.

8. Në rastet e parashikuara në pikën 7 të këtij neni, ministri mund të negociojë një kontratë me kushte lehtësuese me kërkuesin apo zotëruesin e lejes minerare.

9. Në rastet e parashikuara në pikat 7 dhe 8 të këtij neni, kontrata dhe shtyrja e afatit paraqiten

për miratim në Kuvend.

10. Me miratimin e lejes minerare të shfrytëzimit të grupit të mineraleve ndërtimore, zona e lejuar e shfrytëzimit hiqet nga fondi pyjor e kullosor, pronë shtetërore, dhe kalon si pasuri minerare në varësi të ministrisë së linjës, sipas legjislacionit në fuqi për ndryshimin e zërit kadastral të fondit pyjor e kullosor. Në këto raste, leja hyn në fuqi për zbatimin e detyrimeve të saj në datën e ndryshimit të zërit kadastral.

Neni 25

Detyrimet e zotëruesit të lejes së shfrytëzimit me karrierë të mineraleve dhe grupit të mineraleve ndërtimore

Zotëruesi i lejes së shfrytëzimit me karrierë të mineraleve dhe materialeve të ndërtimit, të grupit të mineraleve ndërtimore, ka këto detyrime:

a) të realizojë programin e investimit, të parashikuar në planin vjetor të veprimtarive minerare dhe projektin e zhvillimit të këtyre veprimtarive;

b) të paraqesë pranë strukturës përgjegjëse çdo 3 muaj, jo më vonë se data 15 e muajit që vijon pas tremujorit përkatës, një informacion mbi realizimin e prodhimit, investimeve, vlerën e produkteve të shitura, punimeve minerare të realizuara dhe gjithë operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare, në përputhje me detyrimet e tij të lejes minerare dhe planin vjetor;

c) të paraqesë pranë strukturës përgjegjëse çdo vit, jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i vitit përkatës, raportin financiar dhe teknik të të gjitha operacioneve të kryera, në përputhje me detyrimet e përcaktuara në lejen e tij minerare dhe planin vjetor të punës;

ç) të paraqesë për shqyrtim pranë strukturës përgjegjëse një plan pune vjetor, të hartuar në përputhje dhe të harmonizuar në kohë me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në lejen e tij minerare për çdo vit, jo më vonë se 30 ditë kalendarike përpara përfundimit të vitit, llogaritur nga data e hyrjes në fuqi të lejes. Ky plan duhet të përmbajë, në mënyrë të specifikuar, kapacitetet e prodhimit, vlerën e investimeve, vlerat e garancive të përcaktuara në nenin 31 të këtij ligji, në përputhje dhe të harmonizuar në kohë me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në lejen e tij minerare për çdo vit, të cilat miratohen nga strukturat përgjegjëse jo më vonë se 30 ditë nga data e paraqitjes së tyre. Në rast mosmiratimi, struktura përgjegjëse e njofton zotëruesin e lejes minerare për arsyet e këtij mosmiratimi. Pas tejkalimit të këtij afati, plani quhet i miratuar. Përmbajtja e planit të punës dhe dokumentet e tjera të nevojshme që e shoqërojnë atë duhet të jenë në përputhje me aktet nënligjore të miratuara nga ministri;

d) t'i raportojë strukturës përgjegjëse, në përfundim të afatit të së drejtës së shfrytëzimit, informacion të hollësishëm për investimet e realizuara gjatë shfrytëzimit, për punimet minerare të kryera në zonën e tij të lejuar, shoqëruar me vizatimet inxhinierike. Forma e raportimit përshkruhet në aktet nënligjore që miratohen nga ministri.

SEKSIONI I KATËRT

LEJA MINERARE PËR GRUPIN E MINERALEVE TË ÇMUARA DHE GJYSMË TË ÇMUARA DHE GRUPIN E MINERALEVE RADIOAKTIVE

Neni 26

Leja minerare për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara

1. Leja minerare për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara është leje kërkim-zbulim-shfrytëzimi.

2. Leja minerare për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara i jep zotëruesit të lejes të drejtën ekskluzive të kërkojë, të zbulojë dhe të shfrytëzojë një ose më shumë minerale të grupit të mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara, për të cilat i është dhënë leja, por brenda zonës së lejuar.

3. Leja jepet për një zonë të lejuar, që është një e tërë, jo më e vogël se vlera e përcaktuar në tabelën e miratuar me vlerat minimale të sipërfaqeve të lejeve minerare, sipas programit të veprimit dhe jo më e madhe se 10 km^2.

4. Leja nuk mund të jepet për një zonë të lejuar, që është objekt i një lejeje tjetër kërkim-zbulim-shfrytëzimi, të vlefshme sipas këtij ligji, që zotërohet nga një subjekt tjetër.

5. Subjekti mund të përfitojë më shumë se një leje për zona të ndryshme, të lejuara.

6. Leja minerare për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara ka afat vlefshmërie jo më të gjatë se 25 vjet nga data e hyrjes së saj në fuqi dhe është subjekt i një shtese deri në 10 vjet, me kusht që kjo shtyrje afati të kërkohet nga zotëruesi i lejes minerare, të paktën, 180 ditë kalendarike para përfundimit të afatit të vlefshmërisë.

Neni 27

Të drejtat dhe detyrimet e zotëruesit të lejes minerare për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara

1. Zotëruesi i lejes së kërkim-zbulim-shfrytëzimit për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara ka të drejtë:

a) të ushtrojë çdo të drejtë, në përputhje me lejen minerare që i është dhënë;

b) të kryejë, brenda zonës së tij të lejuar, çdo veprimtari për kërkim-zbulim-shfrytëzim të mineraleve, për të cilat i është dhënë leja minerare;

c) të nxjerrë prej zonës së vet, të lejuar, të gjitha mineralet, për të cilat i është dhënë leja minerare;

ç) të shesë mineralet e nxjerra, vetëm nëse është i autorizuar, sipas këtij ligji;

d) të realizojë programin e investimit, të parashikuar në planin vjetor të veprimtarisë minerare, dhe projektin e zhvillimit të veprimtarisë minerare.

2. Zotëruesi i lejes së kërkim-zbulim-shfrytëzimit për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara ka këto detyrime:

a) të paraqesë pranë strukturës përgjegjëse çdo 3 muaj, jo më vonë se data 15 e muajit që vijon pas tremujorit përkatës, një informacion mbi realizimin e prodhimit, investimeve, vlerën e produkteve të shitura, punimeve minerare të realizuara dhe të gjitha operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare, në përputhje me detyrimet e tij të lejes minerare dhe planin vjetor;

b) të paraqesë pranë strukturës përgjegjëse çdo vit, jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i vitit përkatës, raportin financiar dhe teknik të të gjitha operacioneve të kryera, në përputhje me detyrimet e përcaktuara në lejen e tij minerare dhe planin vjetor të punës;

c) të paraqesë për shqyrtim pranë strukturës përgjegjëse një plan pune vjetor, të hartuar në përputhje dhe të harmonizuar në kohë me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në lejen e tij minerare për çdo vit, jo më vonë se 30 ditë kalendarike përpara përfundimit të vitit, llogaritur nga data e hyrjes në fuqi të lejes. Ky plan duhet të përmbajë, në mënyrë të specifikuar, kapacitetet e prodhimit, vlerën e investimeve, vlerat e garancive, të përcaktuara në nenin 31 të këtij ligji, në përputhje dhe të harmonizuar në kohë me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në lejen e tij minerare për çdo vit, të cilat miratohen nga strukturat përgjegjëse jo më vonë se 30 ditë nga data e paraqitjes së tyre. Në rast mosmiratimi, struktura përgjegjëse e njofton zotëruesin e lejes minerare për arsyet e këtij mosmiratimi. Pas tejkalimit të këtij afati, plani quhet i miratuar. Format e raportimit përshkruhen në aktet nënligjore që miratohen nga ministri.

3. Zotëruesi i lejes së kërkim-zbulim-shfrytëzimit për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara ka detyrimin të marrë të gjitha masat e nevojshme, për të parandaluar dëmtimin e bimësisë dhe të peizazhit ose të pasurive të tjera, si dhe të rehabilitojë të gjitha dëmtimet në sipërfaqen e tokës, të bëra gjatë kërkim-zbulim-shfrytëzimit.

4. Zotëruesi i lejes së kërkim-zbulim-shfrytëzimit për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara ka detyrimin të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dëmtimin e bimësisë dhe të peizazhit ose të pasurive të tjera dhe të rehabilitojë të gjitha dëmtimet e sipërfaqes së tokës, të cilat janë bërë gjatë kërkim-zbulim-shfrytëzimit.

Neni 28

Lejet minerare për grupin e mineraleve radioaktive

1. Dispozitat e parashikuara në këtë kre për lejet minerare të grupit të mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, zbatohen për të gjitha veprimtaritë minerare të grupit të mineraleve radioaktive, përveçse kur parashikohet ndryshe në pikat e mëposhtme të këtij neni.

2. Lejet e kërkim-zbulimit dhe shfrytëzimit për grupin e mineraleve radioaktive, pas shqyrtimit të plotësimit të kushteve, sipas këtij ligji, propozohen nga ministri për shqyrtim e miratim në Këshillin e Ministrave.

3. Me kërkesë të subjektit kërkues apo të zotëruesit të lejes minerare të grupit të mineraleve radioaktive dhe, nëse paraqitet një plan investimesh, zbatimi i të cilit vlerësohet në interes ekonomik apo shoqëror për komunitetin e zonës përkatëse, leja për këtë grup mund të jepet apo, përkatësisht, të zgjatet, për një periudhë vlefshmërie deri në 99 vjet.

4. Në rastet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, ministri mund të negociojë një kontratë me kushte lehtësuese me kërkuesin apo zotëruesin e lejes minerare.

5. Në rastet e parashikuara në pikat 3 dhe 4 të këtij neni, kontrata dhe shtyrja e afatit paraqiten për miratim në Kuvend.

6. Me miratimin e lejes minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve radioaktive, zona e lejuar e shfrytëzimit hiqet nga fondi pyjor e kullosor, pronë shtetërore, dhe kalon si pasuri minerare, në varësi të ministrisë së linjës, sipas legjislacionit në fuqi për ndryshimin e zërit kadastral të fondi pyjor e kullosor. Në këto raste, leja hyn në fuqi për zbatimin e detyrimeve të saj në datën e ndryshimit të zërit kadastral.

KREU IV
PROCEDURAT E DHËNIES SË LEJEVE, LICENCAVE DHE AUTORIZIMEVE

SEKSIONI I PARË
PROCEDURAT E LEJIMIT

Neni 29
Kushtet e përfitimit të lejeve minerare

1. Lejet minerare, të parashikuara në kreun III të këtij ligji, u jepen subjekteve, personave juridikë, vendas apo të huaj, që:

a) nuk kanë humbur të drejtën për t'u pajisur me një licencë minerare, sipas këtij ligji;

b) kanë aftësitë teknike të nevojshme;

c) kanë përvojë në fushën minerare;

ç) paraqesin një projekt të veprimtarisë minerare të kërkim-zbulimit dhe shfrytëzimit, në përputhje me rregullat teknike;

d) paraqesin një plan rehabilitimi të mjedisit për lejet e kërkim-zbulimit e të shfrytëzimit, në përputhje me rregullat e mbrojtjes së mjedisit, të miratuara sipas legjislacionit në fuqi dhe me rregullat teknike minerare;

dh) paraqesin, për lejet që përfshijnë kërkim-zbulimin e shfrytëzimin, një plan të mbylljes së veprimtarive minerare, një plan të menaxhimit të mbetjeve, që janë pjesë të planit të rehabilitimit të mjedisit, të përshtatshëm e në përputhje me rregullat teknike minerare dhe të mjedisit;

e) paraqesin sigurinë e nevojshme financiare për ushtrimin e së drejtës minerare të kërkuar;

ë) paraqesin dokumentin që përcakton shprehjen e mendimit me shkrim të njësive të qeverisjes vendore për lejet që përfshijnë kërkim-zbulimin dhe shfrytëzimin.

2. Përmbajtja e projektit të veprimtarisë minerare, të planit vjetor të veprimtarive minerare, të planit të rehabilitimit, si dhe e rregullave të detyrueshme që duhen plotësuar e atyre teknike përkatëse, përcaktohen me urdhër të ministrit.

3. Përjashtimisht, plotësimi i kushteve, të përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës 1 të këtij neni, nuk kërkohet për lejet e parashikuara në nenin 23 të këtij ligji.

Neni 30
Procedurat e dhënies së lejeve minerare

1. Leja minerare jepet nga Qendra Kombëtare e Licencimit, në përputhje me ligjin nr.10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", sipas procedurës

së konkurrimit publik, për zonat e publikuara, sipas programit të veprimit dhe planit vjetor minerar dhe/apo shqyrtimit të plotësimit të kushteve të lejimit për zonat e hapura, sipas procedurës "I pari në kohë, i pari në të drejta". Procedura e shqyrtimit të kërkesave për zonat e hapura, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Lejet minerare të përcaktuara në këtë ligj përfshihen në kategorinë IV.1 të shtojcës së ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë". Këshilli i Ministrave vendos për dhënien e lejes, sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" ose sipas dispozitave të këtij ligji, sipas ndarjes në nënkategori. Në rastin e dytë nuk zbatohet parimi i miratimit në heshtje.

3. Për lejet e kërkim-zbulimit, vendimi përfundimtar i miratimit të lejes njoftohet dhe hyn në fuqi në datën e publikimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Për lejet, që përfshijnë shfrytëzimin, vendimi përfundimtar i miratimit, përveç rasteve kur, sipas këtij ligji, parashikohet miratimi nga Këshilli i Ministrave ose nga Kuvendi, njoftohet nëpërmjet publikimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Kërkuesi i lejes minerare, që përfshin kërkim-zbulimin dhe shfrytëzimin, duhet të paraqesë dokumentin e garancisë financiare, për zbatimin e planit të rehabilitimit të mjedisit të zonës minerare, që përfshin mbylljen e veprimtarisë minerare, rehabilitimin e sheshit të depozitimit të mbetjeve minerare dhe rehabilitimin e mjedisit të zonës minerare, jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga data:

a) e njoftimit të vendimit të miratimit, sipas pikave 3 e 4 të këtij neni;

b) e publikimit në Fletoren Zyrtare të vendimit të Këshillit të Ministrave për miratimin e lejes, sipas pikës 2 të nenit 28 të këtij ligji;

c) e publikimit në Fletoren Zyrtare të miratimit nga Kuvendi për lejet me afat deri në 99 vjet, sipas neneve 16 pika 5, 24 pika 9 dhe 28 pika 5 të këtij ligji.

6. Kërkuesi i lejes minerare të kërkim-zbulimit duhet të paraqesë dokumentin e garancisë financiare për zbatimin e programit minimal të punës, jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga data:

a) e njoftimit të vendimit të miratimit, sipas pikës 3 të këtij neni;

b) e publikimit në Fletoren Zyrtare të vendimit të Këshillit të Ministrave për miratimin e lejes, sipas pikës 2 të nenit 28 të këtij ligji.

7. Kërkuesi i lejes minerare të shfrytëzimit duhet të paraqesë dokumentin e garancisë financiare për realizimin e investimit, jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga data:

a) e njoftimit të vendimit të miratimit sipas pikës 4 të këtij neni;

b) e publikimit në Fletoren Zyrtare të vendimit të Këshillit të Ministrave për miratimin e lejes, sipas pikës 2 të nenit 28 të këtij ligji;

c) e publikimit në Fletoren Zyrtare të miratimit nga Kuvendi për lejet me afat deri në 99 vjet, sipas neneve 16 pika 5 e 24 pika 9 e 28 pika 5 të këtij ligji.

8. Leja minerare, që përfshin shfrytëzimin, hyn në fuqi pas plotësimit të detyrimit, sipas pikave 5 e 7 të këtij neni, dhe publikohet në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Data e publikimit është data e hyrjes në fuqi.

9. Lejet minerare, që përfshijnë kërkim-zbulimin, hyjnë në fuqi pas plotësimit të detyrimit, sipas pikave 5 e 6 të këtij neni, dhe publikohen në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Data e publikimit është data e hyrjes në fuqi.

10. Në rast mosparaqitjeje të dokumenteve brenda afatit të parashikuar në pikat 5, 6 e 7 të këtij neni, vendimi për miratimin e lejes minerare vlerësohet automatikisht i revokuar.

11. Kushtet e hollësishme të lejimit për përfitimin e lejes, dokumentet shoqëruese, afatet për vlerësimin e përmbushjes së kushteve, afati për paraqitjen e dokumenteve, që provojnë plotësimin e kushteve, organi kompetent për shqyrtimin e kushteve të lejimit e procedurat e shqyrtimit e të miratimit të lejeve minerare përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 31

Garancitë financiare për zhvillimin e veprimtarive minerare

1. Garancia financiare për rehabilitimin e mjedisit përllogaritet në vlerë monetare dhe përdoret nga zotëruesi i lejes ose shteti për realizimin e planit të rehabilitimit përfundimtar të mjedisit, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Ajo depozitohet pas marrjes së lejes minerare çdo vit, në datën efektive të

marrjes së lejes dhe vlera vjetore përcaktohet në bazë të vlerës së përgjithshme të garancisë financiare për realizimin e planit për rehabilitimin e mjedisit, të miratuar nga ministri, të viteve të jetëgjatësisë së lejes minerare dhe të sasisë së mineralit të programuar për t'u shfrytëzuar çdo vit, sipas planit vjetor të veprimtarisë minerare. Vlera totale e garancisë financiare për rehabilitimin e mjedisit, rehabilitimin e sheshit të depozitimit të mbetjeve dhe realizimin e planit të aktiviteteve për mbylljen e veprimtarisë minerare vlerësohet nga struktura përgjegjëse dhe miratohet nga ministri. Ajo përfshin garancinë financiare për mbylljen e veprimtarisë minerare, mbylljen e sheshit të depozitimit të mbetjeve dhe rehabilitimin përfundimtar të mjedisit.

2. Garancia financiare për realizimin e programit minimal të punës përllogaritet në vlerë monetare dhe i kthehet zotëruesit të lejes pas realizimit të programit minimal të punës së lejes minerare të kërkim-zbulimit, në periudha kohore, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Ajo depozitohet çdo vit pas marrjes së lejes sipas dispozitave të këtij ligji. Kjo vlerë përcaktohet në bazë të veprimtarive minerare, që duhet të realizojë minimalisht çdo zotërues i lejes minerare të kërkim-zbulimit në programin minimal të punës, që është pjesë e projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare. Vlera e garancisë financiare për realizimin e programit minimal për lejet e kërkim-zbulimit dhe vlera e investimit me afatet për lejet e shfrytëzimit vlerësohet nga struktura përgjegjëse dhe miratohet nga ministri.

3. Garancia financiare për realizimin e investimit përllogaritet në vlerë monetare dhe i kthehet zotëruesit të lejes së shfrytëzimit pas realizimit të investimit në periudha kohore, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Ajo depozitohet pas marrjes së lejes minerare të shfrytëzimit, çdo vit, në datën efektive të dhënies së lejes. Vlera e saj llogaritet në 10 për qind të vlerës së investimit vjetor, që përcaktohet në projektin e zhvillimit të veprimtarisë minerare për çdo leje minerare shfrytëzimi. Garancia financiare vjetore depozitohet në datën efektive të marrjes së lejes dhe vlera vjetore përcaktohet në bazë të vlerës së përgjithshme të investimit, të miratuar nga ministri, të viteve të investimit dhe të vlerës së investimit të programuar për çdo vit, sipas planit vjetor të veprimtarisë minerare. Vlera e garancisë financiare për realizimin e programit të investimit për lejet e shfrytëzimit vlerësohet nga struktura përgjegjëse dhe miratohet nga ministri.

4. Garancitë financiare vlerësohen nga struktura përgjegjëse, në bazë të vlerësimit të planit të rehabilitimit të mjedisit, të planit të mbylljes së veprimtarisë minerare, të planit të rehabilitimit të sheshit të depozitimit, të planit të zhvillimit të veprimtarisë minerare dhe të planit vjetor të veprimtarisë minerare, që miratohen nga ministri.

5. Vlera e garancisë financiare për zbatimin e planit të rehabilitimit përfundimtar të mjedisit, sipas përllogaritjeve vjetore, paguhet çdo vit dhe paraqitet së bashku me planin vjetor të veprimtarisë minerare.

6. Forma, rastet e tërheqjes dhe mënyra e llogaritjes së garancisë financiare përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Kjo garanci financiare përdoret nga zotëruesi i lejes pas miratimit të ministrit, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

7. Zotëruesit e lejeve minerare të kërkim-zbulimit dhe të shfrytëzimit, brenda një periudhe njëvjeçare pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të paraqesin për shqyrtim e miratim planin e rehabilitimit të mjedisit, që përmban vlerën e garancisë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit përfundimtar të mjedisit. Struktura përgjegjëse duhet të përcaktojë vlerën e papaguar të kësaj garancie.

8. Vlera e papaguar për garancinë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit përfundimtar të mjedisit shpërndahet në mënyrë të barabartë për t'u paguar në periudhën e mbetur të lejes minerare. Zotëruesi i lejes minerare e paguan këtë vlerë çdo vit, mbi vlerën e garancisë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit të mjedisit, që llogaritet sipas përcaktimeve të këtij ligji.

9. Vlera e garancisë financiare për zbatimin e programit minimal të punës së lejeve kërkim-zbulimit reduktohet çdo 6 muaj gjatë periudhës së realizimit të programit minimal të punës, me një vlerë të barabartë me shumën e shpenzuar nga zotëruesi i lejes minerare gjatë realizimit të programit të tij të punës gjatë këtij gjashtëmujori. Reduktime të tilla janë efektive, në përputhje me deklarimin me shkrim, çdo gjashtë muaj, të kryer nga struktura përgjegjëse për zotëruesin e lejes minerare.

10. Gjatë periudhës kur është i pajisur me leje, zotëruesi i lejes minerare të kërkim-zbulimit kryen programe pune minimale, siç përshkruhet dhe jepet me hollësi në programin e punës. Kur zotëruesi i lejes minerare, në përfundim të periudhës së lejes, ka dështuar për kryerjen, plotësisht ose pjesërisht, të programit minimal të punës, atëherë i paguan shtetit një sasi të barabartë me pjesën e

paplotësuar të angazhimit financiar për programin minimal të punës që kryhet, duke kaluar në favor të shtetit pjesën e pakthyer të garancisë financiare për programin minimal të punës.

11. Vlera e garancisë vjetore financiare për realizimin e investimit paguhet çdo vit dhe paraqitet së bashku me planin vjetor të veprimtarisë minerare, për të gjitha vitet e veprimtarisë minerare, kur realizohet investimi, sipas vlerës dhe afateve të përcaktuara në projektin e zhvillimit të veprimtarive minerare dhe planin vjetor të veprimtarisë minerare.

12. Vlera e garancisë vjetore financiare për realizimin e investimit për lejet e shfrytëzimit reduktohet në fund të vitit të punës, llogaritur në bazë të datës efektive të dhënies së lejes, me një vlerë të barabartë, të llogaritur mbi vlerën 90 për qind të investimit të shpenzuar nga zotëruesi i lejes minerare gjatë realizimit të programit të tij të investimit gjatë atij viti. Reduktime të tilla janë efektive, në përputhje me deklarimin me shkrim të kryer nga struktura përgjegjëse për zotëruesin e lejes minerare.

13. Kur zotëruesi i lejes minerare të shfrytëzimit, në përfundim të vitit të punës, të përcaktuar sipas datës efektive të dhënies së lejes minerare, ka dështuar për kryerjen, plotësisht ose pjesërisht, të programit të investimit të parashikuar për atë vit, atëherë pjesa e pakthyer e garancisë financiare për programin e investimit të atij viti kalon në favor të shtetit.

SEKSIONI I DYTË
AUTORIZIMI I TREGTIMIT DHE LICENCIMI I VEPRIMTARIVE STUDIMORE PROJEKTUESE

Neni 32
Autorizimi i tregtimit për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara

1. Tregtimi për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara kryhet vetëm në bazë të autorizimit të tregtimit.

2. Kushtet e autorizimit, dokumentet shoqëruese, afatet e vlefshmërisë dhe procedurat e shqyrtimit të kërkesës për autorizim përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 33
Licencimi i veprimtarive studimore-projektuese

1. Veprimtaritë studimore projektuese në fushën minerare mund të kryhen vetëm nga subjektet e licencuara për këtë qëllim.

2. Licencohen për kryerjen e veprimtarive studimore-projektuese në fushën minerare personat fizikë ose juridikë, të regjistruar si të tillë, që kanë aftësi teknike dhe përvojën e nevojshme për kryerjen e këtyre veprimtarive.

3. Subjektet licencohen nga Qendra Kombëtare e Licencimit, në përputhje me ligjin nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

4. Kategoritë e licencave të studim-projektimit përfshihen në kategorinë IV.4 të shtojcës së ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”. Kushtet e licencimit, dokumentet shoqëruese, afatet e vlefshmërisë dhe procedurat e shqyrtimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU V
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PËRGJITHSHME TË ZOTËRUESIT, RENTA MINERARE

SEKSIONI I PARË
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PËRGJITHSHME

Neni 34
Servituti minerar dhe ndryshimi për interes publik i pronësisë së sipërfaqes së zonës së lejuar të një lejeje minerare

1. Zotëruesi i lejes minerare gëzon të drejtën e servitutit ligjor (të detyrueshëm) minerar mbi pronën në zonën e lejuar minerare, të përcaktuar nga leja.

2. Servituti minerar i jep zotëruesit të lejes minerare të drejtën të përdorë pronën shërbyese dhe të kryejë në të të gjitha veprimet apo punimet mbështetëse, në përputhje me tipin e lejes minerare, si dhe detyron pronarin e pronës shërbyese ta lejojë zotëruesin e lejes të përdorë pronën dhe të kryejë këto veprime e punime.

3. Ushtrimi i së drejtës së servitutit, të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, bëhet në bazë të kontratës së lidhur ndërmjet palëve, ku përcaktohet mënyra e ushtrimit të servitutit, dhe kundrejt pagesës së dëmit.

4. Kur palët nuk arrijnë të lidhin një kontratë brenda një afati 30-ditor nga data e kërkesës me shkrim nga zotëruesi i lejes, drejtuar titullarit të së drejtës së pronësisë, zotëruesi i lejes mund t'i drejtohet gjykatës. Gjykata përcakton pagesën e dëmit dhe rregullat e ushtrimit të servitutit. Në rastin e lejeve minerare, që jepen në përputhje me ligjin për koncesionet, çështja gjykohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

5. Afati i servitutit është afati i vlefshmërisë së lejes minerare dhe rregullat e ushtrimit të servitutit përcaktohen sipas parimit të dëmit më të vogël për pronën shërbyese dhe sipas tipit të lejes minerare.

6. Në rastet kur veprimtaria minerare për një zonë të lejuar minerare është me interes të veçantë publik dhe krijohen probleme në marrëdhënie me pronarin e tokës, sipërfaqja e zonës së lejuar të lejes minerare shpronësohet. Kriteret dhe procedura e shpronësimit përcaktohen në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për shpronësimet me interes publik.

Neni 35

Të drejtat e zotëruesit të lejes minerare mbi pasuritë e paluajtshme fqinje

1. Zotëruesi i lejes minerare gëzon të drejtën e servitutit ligjor (të detyrueshëm) të kalimit në terrenin fqinj, të nevojshëm për hyrjen dhe kryerjen e veprimtarisë në zonën e lejuar minerare, të përcaktuara nga leja minerare.

2. Ushtrimi i së drejtës së servitutit, të parashikuar nga pika 1 e këtij neni, bëhet në bazë të kontratës së lidhur ndërmjet palëve, që përcakton mënyrën e ushtrimit të servitutit dhe kundrejt pagesës vjetore të titullarit të së drejtës së pronësisë së tokës të terrenit fqinj.

3. Nëse palët nuk arrijnë një marrëveshje, brenda një afati 30-ditor nga data e paraqitjes së kërkesës me shkrim nga zotëruesi i lejes, drejtuar titullarit të së drejtës së pronësisë së terrenit, zotëruesi i lejes mund t'i drejtohet gjykatës. Gjykata përcakton pagesën vjetore dhe rregullat e ushtrimit të servitutit. Në rastin e lejeve minerare, që jepen sipas ligjit për koncesionet, çështja gjykohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

4. Afati i servitutit është afati i vlefshmërisë së lejes minerare dhe terreni shërbyes përcaktohet sipas parimit të dëmit më të vogël për pronën shërbyese.

Neni 36

Detyrimet e përgjithshme gjatë ushtrimit të veprimtarisë minerare

Përveç sa parashikohet në këtë ligj, për çdo tip lejeje minerare, zotëruesi i saj, gjatë periudhës së vlefshmërisë, ka edhe këto detyrime:

1. Të paraqesë në çdo vit të vlefshmërisë së lejes dhe brenda datës së vitit vazhdues, që i korrespondon hyrjes në fuqi të lejes, dokumentin e garancisë financiare, për zbatimin e planit të rehabilitimit të mjedisit të zonës minerare.

2. Të paguajë rentën minerare, sipas tipit të lejes minerare, në afatet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

3. Të marrë masat e nevojshme të sigurisë për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e punonjësve e të personave të tjerë, të cilët hyjnë në zonën e lejes minerare, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e teknikës së sigurimit e të mbrojtjes në punë.

4. Të marrë masat e nevojshme për sigurimin e kushteve të punës, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Të bëjë sigurimin e punonjësve të punësuar në veprimtarinë minerare nga aksidentet në punë, sipas rregullave të sigurimit, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

6. Të sigurojë shërbimet mjekësore në zonën e lejuar apo pranë saj, sipas legjislacionit në fuqi.

7. Të ndërmarrë trajnimin e detyrueshëm të personelit, sipas legjislacionit në fuqi.

8. Të lejojë dhe të krijojë kushtet optimale për inspektimin e operacioneve të punës nga strukturat përgjegjëse.

9. Ta ushtrojë veprimtarinë minerare në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit.

10. Të marrë masat e nevojshme për parandalimin e ndotjeve.

11. Të realizojë dhe të paraqesë pranë strukturës përgjegjëse informacionet tremujore mbi realizimin e prodhimit, investimeve, vlerën e produkteve të shitura, punimeve minerare të realizuara dhe gjithë operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare, në përputhje me detyrimet e tij të lejes minerare dhe planin vjetor.

12. Të paraqesë pranë strukturës përgjegjëse çdo vit raportin financiar dhe teknik të të gjitha operacioneve të kryera, në përputhje me detyrimet e përcaktuara në lejen e tij dhe planin vjetor të punës.

13. Të paraqesë çdo vit për shqyrtim pranë strukturës përgjegjëse një plan pune vjetor, të hartuar në përputhje dhe të harmonizuar në kohë me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në lejen e tij minerare.

14. Të paraqesë çdo vit për miratim kapacitetet e prodhimit, vlerën e investimeve, vlerat e garancive të përcaktuara në nenin 31 të këtij ligji, në përputhje dhe të harmonizuar në kohë me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në lejen e tij minerare.

15. Të paraqesë çdo vit raportin mbi pagesat për taksat vendore dhe kombëtare, garancinë financiare të miratuar për rehabilitimin përfundimtar të mjedisit, në përputhje me planin e veprimtarive të mbylljes së minierës dhe projektin e rehabilitimit të mjedisit dhe planin e menaxhimit të mbetjeve minerare dhe garancinë financiare të miratuar për realizimin e investimit dhe programit minimal të punës.

16. Të ruajë konfidencialitetin e të dhënave, të marra nga struktura përgjegjëse, në kushtet e ligjit, si dhe të dhënave të nxjerra gjatë veprimtarisë nga vetë zotëruesi.

17. Të mos përdorë nëntokën ose punimet e tjera nëntokësore, si pus, traverbank, galeri, shpim ose hyrje tjetër në nëntokë, për depozitimin apo hedhjen e mbeturinave, të mbetjeve të rrezikshme, toksike, radioaktive ose të mbeturinave të tjera të kësaj natyre.

18. Të respektojë të gjitha kërkesat për depozitimin, trajtimin dhe menaxhimin e mbetjeve minerare dhe trajtimin e ujërave që dalin nga objektet minerare dhe ato të depozitimit të mbetjeve.

19. Të përgjigjet për dëmet që u ka shkaktuar shtetit dhe palëve të treta, sipas legjislacionit në fuqi.

20. Të marrë licencën, autorizimin apo lejen përkatëse, nëse për kryerjen e një veprimtarie, një veprimi apo për përdorimin e një të mire publike në zonën e lejuar, që, sipas lejes, nuk është pjesë e të drejtave të zotëruesit të lejes minerare, kërkohet miratim paraprak nga organet shtetërore.

21. Të ndalojë veprimtarinë dhe të informojë menjëherë strukturën përgjegjëse për gjetjen në zonën e lejuar të çdo vlere të trashëgimisë kulturore, monetare, historike, natyrore etj.

22. T'i japë informacione dhe shpjegime strukturës përgjegjëse sa herë kërkohet.

23. Të raportojë të dhënat dhe informacionet e detyrueshme, të përcaktuara për çdo lloj lejeje, sipas këtij ligji. Mënyra e raportimit përcaktohet me udhëzim të ministrit.

24. Të respektojë lejimin e kalimit të subjekteve të tjera të përcaktuara në kushtet e lejes së tij minerare, kur zona e tij e lejuar minerare shërben për hyrjen dhe kryerjen e veprimtarisë në zonën e lejuar minerare të subjektit në krah të tij.

25. Në kuadër të nismës për transparencë në industrinë nxjerrëse, subjektet duhet:

a) të raportojnë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në aktet nënligjore që hartohen sipas detyrimeve të përcaktuara në nismën për transparencë në industrinë nxjerrëse;

b) forma e raportit teknik, financiar apo të pagesave të taksave duhet të jetë në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare për industrinë nxjerrëse;

c) veprimtaria minerare e subjekteve minerare në Shqipëri dhe veprimet e tyre financiare me

kompanitë mëma ose bija jashtë shtetit duhet të kryhen në përputhje me vlerat e kostove ose me një fitim të arsyeshëm të paracaktuar në programet e tyre të veprimtarisë minerare.

Neni 37

Detyrimi i rehabilitimit të zonës së lejes minerare

1. Parimet bazë për hartimin e planit të rehabilitimit të mjedisit, të planit të veprimtarive të mbylljes së veprimtarisë minerare, të mënyrës së përcaktimit të zonës së rrezikshme të një të drejte minerare, të planit të menaxhimit të mbetjeve minerare hartohen nga strukturat përgjegjëse, në këshillim me njësitë e qeverisjes vendore, duke marrë parasysh kërkesat e legjislacionit minerar e mjedisor në fuqi, dhe miratohen nga ministri.

2. Përveç sa parashikohet më sipër në këtë ligj, për çdo tip lejeje minerare, zotëruesi i lejes minerare ka detyrimin që, gjatë veprimtarisë minerare dhe në përfundim të saj, të zbatojë planin e veprimtarive të mbylljes së objektit minerar, planin e rehabilitimit të mjedisit të zonës minerare dhe planin e menaxhimit të mbetjeve minerare, miratuar nga struktura përgjegjëse, së bashku me lejen minerare, si pjesë të kësaj lejeje.

3. Rehabilitimi i zonës së lejuar minerare kryhet nga vetë zotëruesi i lejes apo nga subjektet e kontraktuara nga ai dhe nën përgjegjësinë e zotëruesit, në mënyrë progresive dhe brenda afateve kohore të përcaktuara, sipas planit të veprimtarive të mbylljes së minierës e atij të rehabilitimit të mjedisit.

4. Kontrolli i zbatimit të planeve përkatëse të mbylljes së veprimtarisë minerare e të rehabilitimit të mjedisit kryhet nga struktura përgjegjëse, e cila, pas inspektimit, i raporton ministrit. Rehabilitimi vlerësohet i përfunduar vetëm pas miratimit nga ministri të raportit përfundimtar, të hartuar nga struktura përgjegjëse, për të cilin njoftohet me shkrim zotëruesi i lejes minerare. Pas këtij miratimi zotëruesit të lejes minerare i rikthehet pjesa e garancisë financiare e pashpenzuar për realizimin e planit të veprimtarive të mbylljes së objektit minerar dhe të planit të rehabilitimit të mjedisit.

5. Në rastin kur zotëruesi i lejes minerare, që përfshin shfrytëzimin, braktis zonën e lejes minerare apo nuk përfundon zbatimin e plotë të planit të rehabilitimit, rehabilitimi kryhet nga subjekte të specializuara, të përzgjedhura nga struktura përgjegjëse, sipas procedurave të prokurimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Shpenzimet përballohen me fondet e garancisë financiare.

6. Nëse garancia financiare për zbatimin e planit të rehabilitimit, sipas pikës 5 të këtij neni, nuk është e mjaftueshme, zotëruesi i lejes minerare mbetet përgjegjës për vlerën e shpenzuar mbi fondin e garancisë së përdorur për rehabilitimin e plotë.

7. Mosrealizimi i planit të rehabilitimit nga zotëruesi i lejes i heq të drejtën atij të përfitojë leje për një veprimtari tjetër minerare, për një periudhë 50-vjeçare, që llogaritet nga fundi i afatit të vlefshmërisë së lejes së parë dhe përbën shkak për revokimin e çdo lejeje tjetër të vlefshme të të njëjtit zotërues, të dhënë sipas këtij ligji.

Neni 38

Mbetjet minerare

1. Mbetjet minerare duhet të trajtohen me synim uljen e nivelit ndotës së tyre në tokë, në ujërat, te flora e fauna dhe në ekosistemin, në përgjithësi, në vlerat minimale, të pranuara sipas legjislacionit në fuqi, duke promovuar proceset e riciklimit, që sasia e depozituar të jetë sa më e vogël.

2. Vendi dhe mënyra e depozitimit të tyre, sipas përbërjes, duhet të jenë të sigurta, në përputhje me kërkesat mjedisore të komunitetit dhe kërkesat e shkarkimeve, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mjedisin, duke shmangur efektet negative të këtij depozitimi në të ardhmen.

3. Mënyra e depozitimit përcaktohet duke pasur parasysh kushtet e terrenit, stabilitetin gjeoteknik dhe duhet të garantojë ndotjet për rastet aksidentale, të respektojë nivelet e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për ndotje të ujërave sipërfaqësore, nëntokësore, të florës e të faunës dhe ndikimin në ekosistemin e zonës minerare dhe asaj përreth saj.

4. Për ndotjet aksidentale, zotëruesi i lejes minerare duhet të paraqesë një plan të emergjencës, ku të përfshihen të gjitha masat për garantimin e jetës dhe të shëndetit, shmangien e ndotjeve në mjedis, mënyrën e bashkëveprimit me organin e emergjencave civile, masat për

rehabilitimin e mjedisit për raste aksidentale. Për këtë plan bëhen këshillime me njësitë e qeverisjes vendore.

Ky plan përditësohet çdo 3 vjet dhe miratohet nga struktura përgjegjëse.

5. Trajtimi i mbetjeve sipas karakteristikave të tyre, vendosjes gjeografike dhe kushteve mjedisore duhet të jetë pjesë përbërëse e projektit të zhvillimit minerar, në bazë të teknikave më të përparuara të trajtimit e të depozitimit të tyre, për të garantuar një zhvillim të qëndrueshëm të veprimtarisë minerare, me synim ruajtjen e mjedisit, të sigurisë së jetës dhe të shëndetit të komunitetit.

6. Plani i menaxhimit të mbetjeve minerare duhet të përfshijë karakteristikat e mbetjeve minerare, projektin e depozitimit, mënyrat e trajtimit te mbetjeve minerare, riciklimin, ndikimin në mjedis dhe shëndetin e komunitetit, impaktin gjatë operimit, procedurat e kontrollit e të monitorimit, planin e mbylljes dhe të rehabilitimit të sheshit të depozitimit, nivelin e shkarkimeve në mjedis dhe është pjesë e planit të rehabilitimit.

Ai duhet të programojë masat parandaluese dhe ato të rehabilitimit të depozitave të mbetjeve minerare. Plani i menaxhimit të mbetjeve miratohet nga struktura përgjegjëse. Vlerësimi për efektet e depozitimit të këtyre mbetjeve dhe plani i menaxhimit të mbetjeve përditësohen çdo 5 vjet.

7. Për veprimtaritë minerare, mbetjet e të cilave rezultojnë nga procese ku përdoren lëndë toksike dhe të rrezikshme, si cianure, acide, substanca kimike të rrezikshme, trajtohen sipas një plani të veçantë menaxhimi të mbetjeve, që i shtohet planit të rehabilitimit të mjedisit. Niveli i koncentrimit të elementeve toksike ose të rrezikshme në depozitimet e mbetjeve minerare apo shkarkimet prej tyre, duhet të respektojë kërkesat e përcaktuara në legjislacionin për mjedisin dhe të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme. Ky plan dhe garancia financiare e mbylljes së veprimtarisë dhe rehabilitimit të mjedisit vlerësohen nga struktura përgjegjëse, vlerësim i cili miratohet nga ministri. Vlerësimi i planit dhe i garancisë financiare për efektet e depozitimit të këtyre mbetjeve përditësohet çdo 3 vjet.

8. Zotëruesi i lejes minerare duhet të mbajë informacion të hollësishëm për punimet e kryera për depozitimin dhe për trajtimin e mbetjeve minerare me vizatimet inxhinierike dhe për rezultatet e të gjitha provave e të trajtimeve të mostrave të marra. Forma e raportimit përshkruhet në rregulloren që miratohet nga ministri.

9. Zotëruesi i lejes minerare duhet të respektojë të gjitha kërkesat për depozitimin, trajtimin, menaxhimin e mbetjeve minerare, në përputhje me kërkesat e planit të menaxhimit të mbetjeve minerare, të miratuar.

Neni 39

Prishja e objekteve gjatë zbatimit të planit të rehabilitimit

1. Objektet mbështetëse të veprimtarisë minerare, të ndërtuara në zonën e lejuar minerare, nuk prishen për efekt të zbatimit të planit të rehabilitimit, nëse:

a) është rënë dakord ndërmjet zotëruesit të lejes minerare dhe titullarit të pronës, mbi të cilën ato janë ngritur, sipas legjislacionit në fuqi;

b) kërkohet me shkrim nga struktura përgjegjëse për objektet e ngritura në pronë shtetërore për marrjen në pronësi pa pagesë.

2. Në rastin e parashikuar në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni, objekti kalon në pronësi të titullarit të pronës, mbi të cilën është ngritur, sipas rregullave të parashikuara nga Kodi Civil.

3. Në rastin e parashikuar në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij neni, objekti kalon në pronësi të qeverisjes qendrore apo njësisë së qeverisjes vendore përkatëse, në bazë të procesverbalit të marrjes në dorëzim dhe pa kundërshpërblim. Regjistrimi në regjistrat e pasurive të paluajtshme përjashtohet nga taksat dhe tarifat.

SEKSIONI I DYTË
RENTA MINERARE

Neni 40

Renta minerare

1. Renta minerare është detyrim i zotëruesve të lejeve minerare:

a) të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, grupin e mineraleve radioaktive dhe grupin e mineraleve ndërtimore;

b) të kërkim-zbulim-shfrytëzimit për grupin e mineraleve të gurëve të çmuar e gjysmë të çmuar.

2. Renta minerare llogaritet në përqindje të vlerës së siguruar nga shitja e mineralit të papërpunuar, të prodhuar nga zona e lejuar minerare, dhe derdhet në Buxhetin e Shtetit dhe në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore përkatëse.

3. Vlerat e përqindjeve, forma, mënyra e ndarjes dhe afatet e pagesës së rentës minerare përcaktohen në legjislacionin për taksat kombëtare.

KREU VI
TRANSFERIMI I TË DREJTAVE MINERARE NGA ZOTËRUESI

Neni 41
Transferimi i të drejtave minerare nga zotëruesi

1. Lejet minerare, të dhëna sipas procedurave konkurruese, dhe ato, për të cilat është përfunduar një marrëveshje lehtësuese, nuk janë të transferueshme.

2. Lejet minerare, për të cilat veprimtaria minerare, sipas përcaktimeve të këtij ligji, nuk ka filluar, janë të patransferueshme.

3. Lejet e tjera minerare, të dhëna sipas procedurave të këtij ligji, janë të transferueshme vetëm pas miratimit paraprak nga ministri. Çdo transferim i kryer pa miratimin paraprak është i pavlefshëm.

4. Miratimi apo refuzimi i ministrit, sipas pikës 3 të këtij neni, bëhet brenda një afati prej 60 ditësh kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës së transferimit nga zotëruesi i lejes minerare.

5. Kriteret dhe rregullat e transferimit përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

6. Akti i transferimit depozitohet pranë strukturës përgjegjëse dhe transferimi regjistrohet në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, si ndryshime të titullit të lejes, duke e plotësuar me të dhënat e identifikimit të zotëruesit të ri. Data e transferimit është data e regjistrimit. Akti i transferimit depozitohet edhe në regjistrin minerar.

7. Ndërtimet dhe instalimet e tjera, që mbështesin operacionet kryesore, vlerësohen veprimtari ndihmëse të pandashme të së drejtës minerare dhe transferohen bashkë me të.

Neni 42
Përgjegjësitë e transferimit të lejes minerare

1. Transferuesi i lejes minerare është përgjegjës për të gjitha detyrimet ndaj shtetit deri në çastin e transferimit.

2. Përfituesi i lejes minerare është përgjegjës për të gjitha detyrimet ndaj shtetit.

KREU VII
MBIKËQYRJA, MONITORIMI I VEPRIMTARIVE MINERARE DHE KADASTRA MINERARE

Neni 43
Struktura përgjegjëse

1. Mbikëqyrja dhe monitorimi i veprimtarive minerare kryhen nga struktura përgjegjëse.

2. Struktura përgjegjëse ka këto funksione:

a) parandalimin e rrezikut në fushën minerare, hartimin e hartave të zonave të rrezikut minerar dhe miratimin e zonës së rrezikut minerar të të drejtave minerare;

b) kontrollin e respektimit nga titullari i lejes minerare të kushteve të lejes dhe të normave të detyrueshme të legjislacionit në fuqi për veprimtarinë minerare;

c) kontrollin e zbatimit të këtij ligji;

ç) monitorimin minerar e postminerar të minierave të mbyllura dhe në regjim konservimi;

d) monitorimin e depozitimeve të mbetjeve minerare të minierave në veprimtari të braktisura, të mbyllura dhe në regjim konservimi;

dh) mbështetjen e ministrit për përgatitjen e politikave e të programeve në fushën minerare;

e) shqyrtimin e plotësimit të kushteve të dhënies së lejes dhe organizimin e procedurave të konkurrimit për zonat konkurruese minerare;

ë) shqyrtimin e planeve vjetore të veprimtarisë minerare.

3. Struktura përgjegjëse harton dhe i paraqet ministrit çdo 6 muaj një raport për çdo veprimtari minerare, i cili përmban të dhëna për:

a) respektimin e realizimit të projektit minerar;

b) realizimin e operacioneve e të punimeve minerare dhe depozitimin e mbetjeve minerare;

c) lëvizjen e rezervave minerare;

ç) kryerjen e operacioneve minerare, në përputhje me normat e ruajtjes së mjedisit minerar, duke u këshilluar me njësitë qeverisjes vendore të zonës minerare;

d) respektimin e standardeve të sigurisë në punë e të mbrojtjes së shëndetit të punonjësve, duke dhënë edhe rekomandimet përkatëse.

4. Struktura përgjegjëse ka të drejtë të kryejë inspektime për ndjekjen e respektimit të dispozitave të këtij ligji, të lërë detyra, të marrë masa administrative apo të propozojë marrjen e tyre nga ministri.

5. Struktura përgjegjëse ka të drejtë të kërkojë informacion nga zotëruesi i lejes sa herë ka dyshime se ai përdor praktika të dëmshme kërkimi, zbulimi apo shfrytëzimi të mineraleve dhe të trajtimit të tyre, për respektimin e standardeve mjedisore të pranuara, apo se ai i drejton operacionet e punës në kundërshtim me ato të parashikuara në projektin e miratuar, si dhe çdo të dhënë tjetër, për të llogaritur detyrimet financiare, që ka zotëruesi sipas këtij ligji.

6. Këshilli i Ministrave miraton organizimin e funksionimin e strukturës përgjegjëse në zbatim të këtij ligji.

Neni 44
Kadastra minerare

1. Kadastra minerare dhe regjistri minerar administrohen nga struktura përgjegjëse.

2. Të dhënat e hollësishme e dokumentet përkatëse, që regjistrohen në kadastrën minerare e në regjistrin minerar, procedurat e raportimit nga zotëruesi i lejes minerare dhe rregullat për mbajtjen e regjistrimin e të dhënave përcaktohen me urdhër të ministrit.

KREU VIII
KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE, PEZULLIMI DHE REVOKIMI

Neni 45
Kundërvajtjet administrative

1. Shkeljet e mëposhtme të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

a) kryerja e veprimtarive minerare pa leje minerare, me gjobë në shumën 2 000 000 (dy milionë) lekë për çdo shkelje;

b) mosrespektimi i detyrimeve dhe/apo kushteve që janë përcaktuar në lejen minerare, të lidhura me dëmtimet në zonën e lejes minerare, me gjobë 500 000 (pesëqind mijë) lekë për çdo shkelje;

c) mosrespektimi i detyrimeve dhe/apo kushteve që janë përcaktuar në lejen minerare, të lidhura me mosrespektimin e projektit të aktivitetit minerar, me gjobë 500 000 (pesëqind mijë) lekë për çdo shkelje;

ç) shkelja e dispozitave të neneve 13 pika 5, 18 pika 1 shkronja “b”, 20 pika 1 shkronja “b”,

25 shkronja “b”, 27 pika 2 shkronja “a” dhe 36 pikat 8 dhe 11 të këtij ligji, me gjobë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë për çdo shkelje;

d) shkelja e dispozitave të neneve 13 pika 11, 18 pika 1 shkronja “c”, 25 shkronja “c”, 27 pika 2 shkronja “b” dhe 36 pikat 12, 14, 15 e 23 të këtij ligji, me gjobë 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë për çdo shkelje;

dh) shkelja e dispozitave të neneve 13 pika 12, 18 pika 1 shkronja “ç”, 25 shkronja “ç”, 27 pika 2 shkronja “c” dhe 36 pika 13 dhe pika 25 shkronja “a” të këtij ligji, me gjobë 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë për çdo shkelje;

e) shkelja e dispozitave të neneve 13 pika 13, 18 pika 1 shkronja “ë”, 20 pika 1 shkronja “c” dhe 25 shkronja “d” të këtij ligji, me gjobë 300 000 (treqind mijë) lekë për çdo shkelje;

ë) shkelja e dispozitave të neneve 36 pikat 3, 4, 6, 7 e 10 të këtij ligji, me gjobë 200 000 (dyqind mijë) lekë për çdo shkelje;

f) shkelja e dispozitave të nenit 37 pika 2 të këtij ligji, me gjobë 500 000 (pesëqind mijë) lekë për çdo shkelje;

g) shkelja e dispozitave të nenit 37 pika 3 të këtij ligji, me gjobë 800 000 (tetëqind mijë) lekë për çdo shkelje.

2. Sanksionet e parashikuara në këtë nen mund të ndërmerren nga struktura përgjegjëse, nëse nga data e kryerjes së shkeljes nuk ka kaluar një periudhë më e madhe se 5 vite kalendarike.

3. Shkeljet konstatohen nga punonjësit e strukturës përgjegjëse dhe akti i konstatimit i njoftohet subjektit menjëherë, duke përshkruar shkeljen. Forma e aktit të konstatimit përcaktohet me rregullore dhe miratohet nga ministri.

4. Sanksionet vendosen nga punonjësit e strukturës përgjegjëse jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga data e konstatimit të shkeljes dhe njohjes së shkelësit dhe i njoftohen me shkrim shkelësit.

5. Subjekti, ndaj të cilit vendoset masa administrative, ka të drejtën e ankimit tek titullari i strukturës përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Gjoba paguhet brenda një periudhe prej 30 ditësh kalendarike nga njoftimi i saj, përveçse kur vendimi për dhënien e saj është pezulluar sipas legjislacionit në fuqi.

7. Kryerja për herë të dytë nga i njëjti subjekt i shkeljeve të parashikuara në shkronjat “d” dhe “dh” të pikës 1 të këtij neni dënohet me dyfishin e gjobës së parashikuar dhe mund të shoqërohet me pezullimin e lejes minerare deri në plotësimin detyrimit.

Neni 46

Pezullimi i lejes

1. Leja pezullohet kur:

a) janë dëmtuar kolonat mbrojtëse të parashikuara në projektin e miratuar minerar;

b) zotëruesi i lejes minerare të shfrytëzimit minerar të grupit të mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet apo grupit të mineraleve ndërtimore, përdor praktika të dëmshme të shfrytëzimit të mineraleve dhe të trajtimit të tyre, ose drejton operacionet e punës, në kundërshtim me projektin minerar të miratuar;

c) shkelet dispozita e parashikuar në nenin 36 pikat 5, 16, 17, 18 dhe 21 të këtij ligji;

ç) shkelen dispozitat e parashikuara në nenin 37 pika 3 të këtij ligji;

d) shkelen dispozitat e parashikuara në nenet 13 pika 7, 18 pika 2, 20 pika 1 shkronjat “ç” dhe “d”, 27 pikat 3 dhe 4 dhe 36 pikat 9 dhe 20 të këtij ligji;

dh) kryhen për herë të dytë nga i njëjti subjekt, shkeljet e parashikuara në nenin 47 pika 1 shkronjat “g”, “ gj”, “ h” dhe “ i” të këtij ligji.

2. Pezullimi i lejes nga struktura e përgjegjëse shoqërohet me lënien e detyrave për korrigjimin e shkeljeve. Detyrat zbatohen nga zotëruesi i lejes minerare brenda afatit të pezullimit, përveçse kur përcaktohet ndryshe në aktin e pezullimit. Struktura përgjegjëse verifikon korrigjimin e shkeljeve jo më vonë se 10 ditë nga data e lënë për korrigjimin e shkeljeve. Kur ky afat nuk

respektohet, shkeljet quhen të korrigjuara dhe subjekti mund të rifillojë nga puna.

3. Vendimi i pezullimit merret nga titullari i strukturës përgjegjëse jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga konstatimi i shkakut të pezullimit dhe njohjes së shkelësit dhe i njoftohen me shkrim shkelësit.

4. Shkeljet që bëhen shkak për pezullim konstatohen nga punonjësit e strukturës përgjegjëse dhe akti i konstatimit i njoftohet subjektit menjëherë me përshkrimin e arsyes së pezullimit.

5. Subjekti, ndaj të cilit merret masa e pezullimit, ka të drejtën e ankimit, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 47

Revokimi i lejes

1. Leja revokohet kur:

a) pas dhënies së saj, konstatohet se në dokumentacionin e paraqitur për lejen minerare ka të dhëna të rreme apo se subjekti nuk përmbush kushtet e lejimit;

b) zotëruesi i lejes minerare nuk fillon veprimtarinë minerare në afatin e përcaktuar më poshtë nga hyrja në fuqi e lejes:

i) leje kërkim-zbulimi për të gjitha grupet e mineraleve, 120 ditë kalendarike;

ii) leje shfrytëzimi për të gjitha grupet e mineraleve, 180 ditë kalendarike;

c) zotëruesi i lejes minerare pezullon për 1 vit ose ndërpret veprimtarinë minerare, pa njoftuar më parë, jo më vonë se 90 ditë kalendarike, strukturat përgjegjëse të veprimtarisë minerare, duke përfshirë në njoftim dhe arsyet e këtij pezullimi ose ndalimi;

ç) zotëruesi i lejes minerare, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e çdo viti në vazhdim, që i korrespondon datës së hyrjes në fuqi të lejes, nuk paraqet dokumentin e garancisë financiare të zbatimit të planit të rehabilitimit, dokumentin e garancisë financiare të zbatimit të programit minimal të punës, dokumentin e garancisë financiare të zbatimit të investimit;

d) zotëruesi nuk paguan rentën minerare sipas afateve të legjislacionit në fuqi;

dh) zotëruesi i lejes së shfrytëzimit minerar të grupit të mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet apo grupit të mineraleve ndërtimore vazhdon të përdorë praktika të dëmshme të shfrytëzimit të mineraleve dhe të trajtimit të tyre, ose i drejton operacionet e punës në kundërshtim me projektin e miratuar;

e) zotëruesi i lejes minerare nuk respekton kërkesat e planit të rehabilitimit, të planit të mbylljes së veprimtarisë minerare e të planit të menaxhimit të mbetjeve;

ë) zotëruesi i lejes së kërkim-zbulimit dështon në realizimin e programit minimal të punës;

f) zotëruesi i lejes së shfrytëzimit për dy vjet radhazi dështon në realizimin e 90 për qind të vlerës së investimit, që ka parashikuar në projektin e zhvillimit të veprimtarisë minerare;

g) nuk kryen detyrat e lëna nga struktura përgjegjëse, brenda afateve të caktuara në vendimin e pezullimit, në përputhje me nenin 46 të këtij ligji;

gj) zotëruesi nuk i paraqet informacionet e kërkuara nga struktura përgjegjëse, paraqet informacione të pavërteta apo pengon strukturën përgjegjëse në ushtrimin e funksioneve të inspektimit, në zbatim të këtij ligji;

h) organi kompetent, sipas legjislacionit në fuqi, ka revokuar lejen mjedisore;

i) zotëruesi i lejes minerare nuk respekton kërkesat e shkronjës "c" të pikës 25 të nenit 36 të këtij ligji.

2. Leja minerare, që përfshin shfrytëzimin minerar, revokohet edhe:

a) me kërkesë të zotëruesit, kur ai ka plotësuar të gjitha detyrimet e lejes minerare;

b) kur janë mbaruar rezervat gjeologjike dhe zotëruesi e kërkon revokimin e lejes;

c) kur, për shkaqe natyrore apo gjeologo-minerare, bëhet e papërshtatshme për vazhdimin e shfrytëzimit;

ç) kur vazhdimi i shfrytëzimit të minierës krijon premisa për rreziqe gjeologjike dhe mjedisore.

Neni 48

Procedura e revokimit të lejes

1. Procedura e revokimit të lejes fillon, si rregull, me raportin e propozimit të strukturës përgjegjëse ose me kërkesë të zotëruesit të saj, kur ky i fundit ka plotësuar të gjitha detyrimet e saj.

2. Ministri, në bazë të propozimit të strukturës përgjegjëse, njofton zotëruesin e lejes minerare, duke specifikuar qëllimin e tij për të hequr ose pezulluar lejen minerare dhe arsyen e një veprimi të tillë.

3. Brenda një periudhe 30-ditore nga njoftimi i zotëruesit, ministri vendos revokimin e lejes minerare.

4. Në rastet e parashikuara shkronjën "a" të pikës 2 të nenit 47 të këtij ligji, zotëruesi duhet të njoftojë strukturën përgjegjëse jo më vonë se 1 vit para datës, në të cilën kërkohet revokimi. Njoftimi përmban arsyet e detajuara të mbylljes, dokumentacionin tekniko–ekonomik dhe planin e aktualizuar të rehabilitimit. Me marrjen e kërkesës, njësia përgjegjëse inspekton zonën dhe harton një raport që ia paraqet ministrit.

5. Revokimi në të gjitha rastet vendoset nga ministri, në bazë të raportit të strukturës përgjegjëse.

6. Kundër vendimit të ministrit bëhet ankim në gjykatën administrative, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 49

Detyrimet e zotëruesit pas revokimit të lejes

1. Pas revokimit të lejes, sipas nenit 48 të këtij ligji, zotëruesi i lejes detyrohet të zbatojë planin e rehabilitimit.

2. Zbatimi i sanksioneve administrative të pezullimit apo revokimit të lejes nuk e liron zotëruesin nga detyrimet e këtij ligji dhe nga përgjegjësia civile për dëmin e shkaktuar, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Kur revokohet leja minerare, sipas parashikimeve të këtij ligji, ministri ndjek pa kufizim çdo të drejtë ligjore dhe ndërmerr çdo veprim ligjor, për të vjelë dëmshpërblimin përkatës për dëmet shkaktuar shtetit nga shkeljet e zotëruesit të lejes minerare.

KREU IX

TË DHËNAT MINERARE DHE KONFIDENCIALITETI

Neni 50

Raportimi, pronësia e të dhënave dhe mbrojtja e konfidencialitetit

1. Të gjitha të dhënat për burimet minerare në Republikën e Shqipërisë, pavarësisht nga mënyra e ruajtjes së tyre, i përkasin shtetit shqiptar dhe i vihen në dispozicion strukturës përgjegjëse, me kërkesë të kësaj të fundit dhe në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Zotëruesi i lejes mund të shfrytëzojë të dhënat e sipërpërmendura vetëm në interes të atij vetë dhe vetëm gjatë afatit të vlefshmërisë së lejes minerare.

3. Transferimi i këtyre të dhënave nga zotëruesi apo ish-zotëruesi i lejes palëve të treta mund të bëhet vetëm pas miratimit paraprak nga struktura përgjegjëse.

4. Terminologjia e raportimit të rezervave të zbuluara, sipas kategorive apo të atyre të shfrytëzuara, është unike.

5. Të dhënat për pagesat e taksave vendore dhe kombëtare publikohen, në kuadër të transparencës me publikun për veprimtaritë minerare. Forma dhe mënyra e publikimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Ministri miraton rregullat për përdorimin e të dhënave.

Neni 51

Ruajtja e konfidencialitetit nga institucionet shtetërore

1. Në zonat ku kryhen punime kërkim-zbulimi apo shfrytëzimi, autoritetet shtetërore mund të bëjnë hartografime apo vëzhgime sipërfaqësore, me kusht ruajtjen e konfidencialitetit.

2. Struktura përgjegjëse dhe autoritetet e tjera shtetërore, që kryejnë funksione shtetërore në fushën minerare, në zbatim të këtij ligji apo të legjislacionit minerar në fuqi, janë të detyruara të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave, të marra nga zotëruesi i lejes minerare apo të të dhënave, për të cilat kanë marrë dijeni gjatë ushtrimit të funksionit të tyre e që përbëjnë sekret tregtar, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Shkelja e këtij detyrimi ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi.

3. Të dhënat për pagesat e taksave vendore dhe kombëtare nuk quhen konfidenciale. Ato janë të hapura për publikun, në kuadër të nismës për transparencë në industrinë nxjerrëse. Niveli i konfidencialitetit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Të dhënat teknike dhe provat studimore, që zotëruesi i lejes minerare i dorëzon në strukturën përgjegjëse, janë konfidenciale, me përjashtim të rasteve kur zotëruesi i këtyre të dhënave është dakord që të ndiqet radha si më poshtë:

a) përfundimi i afatit të së drejtës minerare;

b) lënia e zonës, në të cilën janë marrë të dhënat teknike dhe provat studimore;

c) dy vjet më pas nga data e marrjes së këtyre të dhënave dhe provave prej strukturës përgjegjëse;

ç) publikimi i të dhënave të tilla.

Nuk mund të kryhet ekzekutimi i pikës pasardhëse para asaj paraardhëse.

5. Ky nen nuk mund të kufizojë të drejtën e shtetit për të përdorur një informacion të tillë për përgatitjen e raporteve ekonomiko-financiare që i nevojiten atij.

KREU X
MBYLLJA DHE KONSERVIMI I MINIERAVE

Neni 52
Mbyllja e minierave të braktisura

1. Minierat e braktisura janë minierat e shfrytëzuara:

a) nga shteti apo nga zotëruesi i lejes minerare;

b) të cilat, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk janë në proces mbylljeje nga zotëruesi i lejes minerare e që nuk janë në shfrytëzim, në bazë të një lejeje minerare, sipas këtij ligji.

2. Minierat e braktisura kalojnë në regjim mbylljeje dhe monitorimi postminerar vetëm nëse:

a) janë mbaruar rezervat gjeologjike;

b) për shkaqe natyrore apo gjeologo-minerare bëhet i papërshtatshëm vazhdimi i shfrytëzimit;

c) bëhet i papërshtatshëm vazhdimi i shfrytëzimit për motive ekonomike;

ç) shfrytëzimi i mëtejshëm i minierës krijon premisa për rreziqe minerare, gjeologjike dhe mjedisore;

d) zotëruesi i lejes minerare braktis veprimtarinë minerare.

Neni 53
Procedura e mbylljes së objektit minerar

1. Kalimi në regjimin e mbylljes së një miniere të braktisur, të shfrytëzuar nga shteti, miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit, dhe kostot financiare për realizimin e mbylljes e të monitorimit përballohen nga Buxheti i Shtetit.

2. Kalimi në regjim mbylljeje i minierave, për të cilat zotëruesi i lejes minerare ka braktisur veprimtarinë minerare, miratohet nga ministri, me propozimin e strukturave përgjegjëse, dhe kostot financiare për realizimin e mbylljes e të monitorimit përballohen nga vlera e garancisë financiare për mbylljen e objektit minerar dhe rehabilitimin e zonës minerare.

3. Mbyllja e një miniere të braktisur realizohet sipas planit të mbylljes së minierës, të miratuar nga struktura përgjegjëse.

4. Plani i mbylljes së minierës hartohet nga subjekte të specializuara e miratohet nga ministri.

5. Plani i mbylljes zbatohet nga subjekte të specializuara shtetërore ose private, të përzgjedhura sipas procedurave të prokurimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi e nga struktura

përgjegjëse dhe monitorohet nga kjo strukturë.

6. Kontrolli i zbatimit të planit të rehabilitimit kryhet nga struktura përgjegjëse, e cila, pas inspektimit, i raporton ministrit. Rehabilitimi vlerësohet i përfunduar vetëm pas miratimit të raportit për këtë qëllim, të hartuar nga struktura përgjegjëse.

7. Forma dhe përmbajtja e planit të veprimtarive për mbylljen e minierës përcaktohen nga ministri.

8. Për atë pjesë të minierave të braktisura, për të cilat është dhënë leje minerare, kërkuesi i lejes minerare, në procedurën e shqyrtimit të kërkesës për leje minerare, si pjesë të planit të rehabilitimit, duhet të paraqesë edhe planin e mbylljes e të rehabilitimit për pjesën tjetër të braktisur të minierës, pjesë e së cilës është zona e lejuar minerare, për të cilën ai aplikon, madje edhe me parashikimet specifike të kostos për këtë pjesë. Plani i rehabilitimit për këtë pjesë zbatohet nga zotëruesi i lejes minerare, me shpenzimet e tij, brenda një afati kohor, të miratuar në çastin e dhënies së lejes.

Neni 54

Procedura e monitorimit postminerar të një objekti minerar

1. Pas realizimit të mbylljes së një miniere të braktisur, të shfrytëzuar nga shteti, zbatohet procesi i monitorimit postminerar, i cili miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit, dhe kostot financiare për realizimin e monitorimit postminerar përballohen nga Buxheti i Shtetit.

2. Kalimi në regjim monitorimi postminerar i minierave, për të cilat zotëruesi i lejes minerare ka braktisur veprimtarinë minerare dhe është realizuar procesi i mbylljes së minierës, miratohen nga ministri, me propozimin e strukturave përgjegjëse. Kostot financiare për realizimin e monitorimit postminerar përballohen nga vlera e garancisë financiare për rehabilitimin e zonës minerare.

3. Monitorimi postminerar i një miniere të braktisur realizohet sipas planit të monitorimit postminerar, që është pjesë e planit të rehabilitimit të zonës minerare.

4. Plani i monitorimit postminerar zbatohet nga subjekte të specializuara shtetërore ose private, të përzgjedhura sipas procedurave të prokurimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, nga struktura përgjegjëse dhe monitorohet nga ajo.

5. Kontrolli i zbatimit të planit të monitorimit postminerar kryhet nga struktura përgjegjëse.

6. Forma dhe përmbajtja e planit të monitorimit postminerar përcaktohen nga ministri.

Neni 55

Konservimi i minierave

1. Nëse nuk plotësohen kushtet e pikës 2 të nenit 52 të këtij ligji, minierat e braktisura kalojnë në regjim konservimi e monitorimi postminerar.

2. Kalimi në regjimin e konservimit të një miniere të braktisur, të shfrytëzuar nga shteti, miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit dhe kostot financiare për realizimin e konservimit përballohen nga Buxheti i Shtetit.

3. Kalimi në regjim konservimi i minierave, për të cilat zotëruesi i lejes minerare ka braktisur veprimtarinë minerare, miratohen nga ministri, me propozimin e strukturave përgjegjëse dhe kostot financiare për realizimin e konservimit përballohen nga vlera e garancisë financiare për rehabilitimin e zonës minerare.

4. Strukturat, që mbulojnë veprimtarinë minerare, i propozojnë ministrit zonat e lejeve minerare për konservim, në bazë të një projekti konservimi, që përfshin një plan konservimi dhe monitorimi postminerar.

5. Konservimi i një miniere të braktisur realizohet sipas projektit të konservimit të minierës, të miratuar nga ministri.

6. Projekti i konservimit zbatohet nga subjekte të specializuara shtetërore ose private, të përzgjedhura sipas procedurave të prokurimit publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi, nga struktura përgjegjëse dhe monitorohet nga ajo.

7. Mbikëqyrja e procesit të konservimit realizohet nga strukturat përgjegjëse.

8. Forma dhe përmbajtja e projektit të konservimit të minierës miratohen nga ministri.

KREU XI
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 56
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 5 pika 3, 7 pika 2, 8 pikat 3 dhe 4, 14 pika 4, 30 pikat 1 dhe 11, 31 pika 6, 32 pika 2, 33 pika 4, 41 pika 5, 43 pika 6, 50 pika 5 e 51 pika 3 të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri që, brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 8 pikat 6 dhe 7, 13 pikat 10, 12 dhe 13, 18 pika 1 shkronjat "c" dhe "ç", 20 pika 3, 25 shkronjat "ç" dhe "d", 27 pika 2 shkronja "c", 29 pika 2, 36 pika 23, 37 pika 1, 38 pika 8, 44 pika 2, 45 pika 3, 50 pika 6, 53 pika 7, 54 pika 6 dhe 55 pika 8 të këtij ligji.

Neni 57
Shtrirja e efekteve për lejet e dhëna

1. Kërkesat e paraqitura, ato në proces dhe ato të papërfunduara, deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, trajtohen në përputhje me procedurën e zbatuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç rastit kur kërkuesi e tërheq vetë kërkesën dhe vendos ta riparaqesë atë.

2. Për të drejtat minerare të fituara në bazë të ligjit nr. 7796, datë 17.2.1994 "Ligji minerar i Shqipërisë", i ndryshuar, sipërfaqja e zonës së lejuar dhe afati i miratuar nuk ndryshojnë me hyrjen në fuqi të këtij ligji, deri në përfundim të afatit të miratuar. Aplikimi për shtyrje afati kryhet në përputhje me këtë ligj.

3. Kërkesat dhe afatet e nenit 31 të këtij ligji i shtrijnë efektet për të gjitha lejet minerare, që janë dhënë përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji. Zotëruesit e lejes minerare duhet të plotësojnë këto kërkesa brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 58
Shfuqizime

Ligji nr. 7796, datë 17.2.1994 "Ligji minerar i Shqipërisë", i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 59
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6654, datë 26.7.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

ANEKS I LIGJIT PËR SEKTORIN MINERAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË – GRUPET E MINERALEVE

GRUPI I MINERALEVE METALORE, JOMETALORE, QYMYRET DHE BITUMET

Antimoni
Argjendi
Ari
Arseniku
Bakri
Bismuti
Çesiumi
Çinabari
Feldspati
Galena
Garnieriti
Galiumi
Hekuri
Ilmeniti
Indiumi
Kallaji
Kadmiumi
Kobalti
Kolumbiumi
Litiumi
Mangani
Mineralet e hekurit
Mineralet e platinit
Mineralet e tokave
Të rralla
Alumina
Aluniti
Apatiti
Asbesti
Baritet
Boksitet
Berili dhe mineralet e tij
Boratet
Ceoliti
Dhé diatomik
Feldspati
Fosfatet
Grafiti
Grafiti argjilor
Gurët abrazivë
Gurë sapuni
Haliti
Hi shistor
Kalciti
Kloriti
Qymyret
Bitumet
Rërat bituminoze
Molibdebni
Monaziti
Nikeli
Oksidi i hekurit
Osmiumi
Piritet e arsenikut
Platini
Plumbi
Rubidiumi
Rutili
Seleni Germaiumi
Squfuri
Sheelitet
Tantali
Titani
Toriumi
Tungsteni e mineralet e tij
Kromiti
Vanadiumi
Volframi
Vulfeniti
Zinku
Zirkoni
Zhiva
Krioliti
Kripa e gurit
Kuarciti
Lateriti
Magnezitet
Mika
Mineralet e silicit
Perliti
Pigmente të mineraleve
Pirofiliti
Rifet kuarcore
Stralli
Steatiti
Smeraldi
Shpati i Islandës
Talku
Torfat
Topazi
Vermikuliti
Volastoniti
Reshpet nafore
Pirobitumet

GRUPI I MINERALEVE NDËRTIMORE

Ranorët, konglomeratet, traktolitet dhe bazaltet

Agregate detare
Anhidritet
Argjilabentonite
Argjilat për tulla
Argjilat për tubacione
Argjilat për porcelan
Argjilat zjarrduruese
Argjilat dhe shistet
Argjilore (për ndërtim)
Bentonite
Çakëlli (brekçet e shpatit)
Dolomiti
Dhé mbushës
Graniti
Gëlqeorët
Gipsi
Gabrot
Kaolina
Mermeri
Ofikalcitet
Pllakat e ndërtimit
Pllagjiogranitet
Rërat
Serpentina
Sieniti
Shiste argjilore
Travertinat
Tufet
Zhavorët
Zhuret

GRUPI I MINERALEVE TË ÇMUARA DHE GJYSMË TË ÇMUARA

Diamanti
Korundi
Agati
Kalcedoni
Kristalet e kuarcit
Nefriti
Opali
Rubini
Safiri
Rodoniti
Torkuazi
Turmalina

GRUPI I MINERALEVE RADIOAKTIVE

Grupi i mineraleve të Uraniumit
Schoepite
Uraninite
Davidite
Uranophane
Schroeckingerite
Grupi i mineraleve të Toriumit
Thorite
Gummite
Canotite
Monazite
Euxenite
Allanite
Samarskite
Bastnasite Cerite
Polycrase
Betafite
Pyrochlore
Grupi i Autuniteve
Tyuyamunite
Torbenite dhe Meta-Torbenite
Autunite dhe Meta-Autunite
Andersonite

Tokat e rralla që kanë në përbërje: cerium, dysprosium, erbium, europium, gadolinium, holmium, lanthanitum, lutetium, neodymium, praseodymium, samariu, terbium, niobium dhe tulium.

Etj.